

**LIGJI Nr. 05/L -096**

**PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Ky ligj përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
2. Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre si dhe për të gjithë subjektet jo publike që i nënshtrohen aktiviteteve që mund të ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, sipas dispozitave të këtij ligji.
3. Ky ligj ka për qëllim implementimin e Direktivës së BE-së 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren e BE-së Nr. 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij ligji përkufizimet në vijim kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **Akt Terrorist** - përkufizimin e përcaktuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. **Akt ose Transaksion i Dyshimtë** - një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion i tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit dhe interpretohet në përputhje me çdo akt nënligjor të lëshuar nga NJIF-ja për aktet apo transaksionet e dyshimta;
  - 1.3. **Aktiviteti kriminal** - çdo lloj përfshirje kriminale në kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në bazë të legjisllacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;

1.4. **Auditor** - personin fizik i cili është licencuar në përputhshmëri me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;

1.5. **Avokat** - çdo person që është i regjistruar në regjistrin e avokatëve në pajtim me Ligjin për Avokatinë në Kosovë;

1.6. **Bankë** - një subjekt i përkufizuar si bankë sipas Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare;

1.7. **Bankë guaskë** - një bankë ose institucion i angazhuar me aktivitete ekuivalente i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar;

1.8. **Bankë korrespondente** – është banka që ofron shërbime bankare apo të ngjashme për një bankë tjetër (banka përgjegjëse);

1.9. **Bordi Mbikëqyrës i NjIF-K** – Bordin e përbërë nga anëtarë të institucioneve të ndryshme, siç përcaktohet me këtë ligj të cilët mbikëqyrin punën dhe sigurojnë pavarësinë e NjIF-K;

1.10. **BQK** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

1.11. **E drejta në pasuri të paluajtshme** - e drejta që lidhet me pasurinë e paluajtshme, duke përfshirë edhe pronësinë, hipotekën, servitutet dhe të drejtat për shfrytëzimin e pasurisë shoqërore, publike dhe shtetërore;

1.12. **E pagueshme përmes** - llogaritë korresponduese të përdorura drejtpërdrejtë nga një palë e tretë për të zhvilluar biznes në emër të tyre;

1.13. **FATF** - Task Forcën e Veprimit Financiar që është trup i pavarur ndërqeveritar që zhvillon dhe promovon politika për të mbrojtur sistemin financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;

1.14. **Financimi i terrorizmit** - sigurimi ose grumbullimi i mjeteve financiare në çfarëdo lloj mënyre, direkte ose indirekte, me synimin për tu përdorur ose me paramendimin që do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht, apo për përfitim të terroristit apo organizatës terroriste, apo për të kryer cilëndo nga krimet e dhëna sipas neneve 138 dhe 143 të Kodit Penal të Kosovës;

1.15. **Fonde ose pasuri të tjera** - çfarëdo lloj pasurie, materiale ose jo materiale, të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme pavarësisht mënyrës së fitimit dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo lloji, duke përfshirë ato elektronike ose digjitale, të cilat dëshmojnë të drejtën ose interesin në një pasuri të tillë, duke përfshirë, por jo kufizuar në kreditë bankare, çeqet bankare dhe të udhëtarëve, mandapostat, aksionet, letrat me vlerë, çeqet dhe letrat e kreditit si dhe çdo interes, dividendë ose të hyra të tjera ose vlera të cilat shtohen ose rrjedhin nga një pasuri e tillë pavarësisht mënyrës së fitimit;

1.16. **Institucion financiar** - personi ose subjekti që drejton një ose më shumë aktivitete për ose në emër të klientit duke përfshirë aktivitetet si më poshtë:

1.16.1. huadhënien, duke përfshirë por pa u kufizuar në kredinë për konsumatorë; kredinë për hipotekë; faktorizimin (biznesi i blerjes së çeqeve, obligacioneve dhe të ngjashme) me ose pa të drejtë tërheqjeje; dhe financimin e transaksioneve komerciale duke përfshirë edhe humbjen;

1.16.2. qiradhënien financiare, përveç marrëveshjeve për qiradhënie financiare që kanë lidhje me produktet për konsum;

1.16.3. dërgimin e parasë ose të instrumenteve monetare në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe sistemin e dërgimit të parave në mënyrë jozyrtare ose me anë të rrjetit të personave a subjekteve të cilët mundësojnë dërgimin e parave jashtë sistemit tradicional të institucioneve financiare;

1.16.4. këmbimin e parave dhe monedhave;

1.16.5. lëshimin dhe menaxhimin e mënyrave të pagesës, duke përfshirë por jo të kufizuar në kartelat debitore dhe kreditore, çeqet, çeqet e udhëtarëve, urdhërpagesat, çeqet e bankierëve ose paratë elektronike;

1.16.6. dhënien e garancive financiare dhe zotimeve;

1.16.7. tregtimin në emër të personave ose subjekteve të tjera në një ose më shumë nga sa vijon:

1.16.7.1. instrumentet e tregut të parasë, çeqet, bankënotat, certifikatat e depozitave, produktet e prejardhura, që vijnë nga një veprimtari tjetër;

1.16.7.2. këmbimin e valutës së jashtme;

1.16.7.3. këmbimin, shkallën e interesit dhe instrumentet e indeksit;

1.16.7.4. letrat me vlerë të transferueshme; dhe

1.16.7.5. tregtimin e mallrave me transaksione të afatizuara.

1.16.8. menaxhimin e portofolit individual dhe kolektiv;

1.16.9. pjesëmarrjen në emetimin e letrave me vlerë dhe sigurimin e shërbimeve financiare lidhur me këto emetime;

1.16.10. ruajtjen dhe administrimin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide në emër të personave të tjerë;

1.16.11. investimin, administrimin ose menaxhimin e fondeve apo parave në emër të personave ose subjekteve të tjera;

1.16.12. të vepruarit si kompani e sigurimeve, sigurimeve të jetës ose si ndërmjetës i sigurimeve të jetës, siç është përkufizuar në Ligjin për Sigurimet në Kosovë;

1.16.13. të vepruarit si fiduciar siç përcaktohet me Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës.

1.17. **Instrument monetar** - përfshinë monedha ose kartëmonedha, çeqet për udhëtim, çeqet personale, çeqet e bankave, urdhërpagesat, mandapostat, çeqet e bankave me firmën e arkëtarit të çdo lloji dhe letrat me vlerë për investime ose instrumentet e transferueshme në formë të bartësit ose në formë tjetër të atillë që titulli t'i kalohet me rastin e dërgimit;

1.18. **Kazino** - çdo objekt i licencuar që mirëpret dhe akomodon lloje të caktuara të lojërave të kazinos që në shumë raste ndërtohen afër apo në kombinim me hotele, restorante dhe atraksione tjera turistike, siç është definuar me Ligjin për Lojërat e Fatit në Kosovë;

1.19. **Klient** - çdo person që kryen, apo bën përpjekje për të kryer transaksion ose përdorë shërbimet e një subjekti raportues siç përcaktohen në këtë ligj, dhe përfshin çdo pronar ose shfrytëzues ose person ose entitet tjetër në emër të cilit është kryer transaksioni apo janë pranuar shërbimet;

1.20. **Kontabilist** - personin që është kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar profesionale kontabiliteti dhe auditimi, vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, dhe ka të drejtë të përdorë titullin kontabilist i certifikuar, siç përcaktohet me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;

1.21. **Lojërat e fatit** - çdo lojë të luajtur fizikisht me letra, zare, pajisje ose makinë për para, pasuri, çeqe, kredi ose ndonjë përfaqësues tjetër të vlerës, duke përfshirë por pa u kufizuar në lojërat ruletë, keno, bingo, blackjack, poker, bakarat, paygo, automatet, apo çdo lojë ose pajisje tjetër të miratuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, por nuk përfshin lojërat të cilat janë të përjashtuara sipas Ligjit për Lojërat e Fatit në Kosovë;

1.22. **Marrëdhënie afariste** - marrëdhënie profesionale ose komerciale e cila është e lidhur me aktivitetet profesionale të një subjekti raportues me personin fizik ose juridik dhe nga e cila pritet të ketë një element kohëzgjatjeje që nga momenti kur lidhet kontrata.

1.23. **Marrëdhënie korrespondente** do të thotë:

1.23.1. ofrimi i shërbimeve bankare nga një bankë korrespondente, në një bankë tjetër respondente, duke përfshirë por jo kufizuar në sigurimin e përgjegjesisë të llogarisë rrjedhëse ose të tjera dhe të shërbimet e ndërlidhura, si administrimi i parave të gatshme, transferimet e fondeve ndërkombëtare, kleringu, të paguara përmes llogarive dhe shërbimet e huaja të këmbimit;

1.23.2. marrëdhëniet ndërmjet institucioneve financiare dhe në mes të institucioneve financiare ku ofrohen shërbimet e ngjashme, duke përfshirë por jo kufizuar në ato marrëdhënie të themeluara për transaksionet e letrave me vlerë ose transferimet e fondeve.

1.24. **Marrëveshjet juridike** - truste dhe marrëveshje të tjera juridike të ngjashme;

1.25. **Mbikëqyrës sektorial** - për qëllime të këtij ligji nënkupton autoritetet kompetente të përcaktuara me ligjet në fuqi në Kosovë që licencojnë, rregullojnë dhe mbikëqyrin punën e subjekteve raportuese sipas këtij ligji nën kompetencën e tyre për qëllime të zbatimit të këtij ligji;

1.26. **Ngrirja** - ndalimi i transferit, konvertimit, vendosjes ose lëvizjes së fondeve ose ndonjë pasurie tjetër mbi bazat dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së një vendimi gjyqësor ose autoriteti tjetër kompetent. Fondet ose pronat e tjera të ngrira mbeten pronë e personave ose subjekteve që kishin interes në fondet ose pronat e tjera të veçanta në kohën kur u bë ngrirja dhe mund të vazhdojnë të administrohen nga institucioni financiar;

1.27. **Noter** - jurist profesional, zyrtarë publik, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë, për ta ushtruar veprimtarinë e përcaktuar me ligj, siç është definuar me Ligjin për Noterinë në Kosovë;

1.28. **NjIF-K** - Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës;

1.29. **Organizatë joqeveritare (OJQ)** - çdo person juridik të organizuar si organizatë joqeveritare në Kosovë sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare në Kosovë;

1.30. **Para të gatshme** - valutën si mjet këmbimi në formë të monedhës ose kartëmonedhës, e cila qarkullon si para në dorë;

1.31. **Pastrim i parave** - cilindo veprim të specifikuar në nenin 56 të këtij ligji;

1.32. **Pasuri e paluajtshme** - toka, ndërtesat dhe banesat;

1.33. **Person i ekspozuar politikisht**– nënkupton:

1.33.1. persona fizikë të huaj apo vendorë, të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike dhe përfshin si në vijim:

1.33.1.1. udhëheqës të shtetit, udhëheqës të qeverisë, ministër, zëvendësministër, këshilltar politik, shef kabineti;

1.33.1.2. deputet të parlamentit dhe anëtarë të organeve të ngjashme dhe të zgjedhurit nga parlamenti;

1.33.1.3. anëtarë të organeve drejtuese qendrore të subjekteve politike;

1.33.1.4. anëtarë të gjykatës kushtetuese, gjykatës supreme apo ndonjë trupi tjetër gjyqësor të nivelit të lartë gjyqësor ose ushtarak ndaj vendimeve të të cilit nuk mund të ushtrohet ankesë, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme;

1.33.1.5. anëtarë të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të gjykatës së auditorëve dhe bordeve të bankave qendrore ;

1.33.1.6. ambasador apo i ngarkuar me punë apo oficer i rangut të lartë ushtarak;

1.33.1.7. anëtarë të bordit, administratorë, menaxherë apo mbikëqyrës të ndërmarrjeve në pronësi të shtetit;

1.33.1.8. drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe anëtarë të bordeve ose funksione ekuivalente në organizatat ndërkombëtare.

1.33.2. anëtarë të familjes të kategorive të paraparë në paragrafin 1.33.1., përfshijnë si në vijim:

1.33.2.1. bashkëshorti apo çdo person që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin;

1.33.2.2. fëmijë dhe bashkëshortët e fëmijëve apo personat që konsiderohet si ekuivalent me bashkëshortin;

1.33.2.3. prindërit.

1.33.3. person i njohur si bashkëpunëtor të kategorive të paraparë në paragrafin 1.33.1 i ngushtë nënkupton:

1.33.3.1. çdo person fizik i cili njihet se janë pronar të përbashkët përfitues të personave juridikë apo marrëveshjeve juridike, ose çfarëdo marrëdhënie e ngushtë biznesi, me personat e specifikuar në paragrafin 1.33.1.;

1.33.3.2. çdo person fizik i cili është pronar përfitues i personit juridik apo marrëveshjes juridike e cila njihet se është themeluar për përfitime de facto të personit të specifikuar në paragrafin 1.33.1.

1.34. **Profesionist në fjalë** - avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët për tatime;

1.35. **Policia** – Policia e Kosovës siç definohet në Ligjin për Policinë e Kosovës dhe Kodin e procedurës Penale të Kosovës;

1.36. **Pronar Përfitues** - person fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër të të cilit është duke u kryer një transaksion apo aktivitet ose personi i cili kryesisht ushtron kontroll efektiv mbi një subjekt juridik ose marrëveshje ligjore.

1.36.1. Në rastin e personave juridik, pronari përfitues duhet të përfshijë të paktën:

1.36.1.1. personin fizik i cili ka në pronësi ose kontrollon përfundimisht një subjekt juridik nëpërmjet pronësisë ose kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përqindjeje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votës në atë subjekt juridik, përfshirë edhe mbajtësit e pronësisë mbi aksionet bartëse, përveç personave juridik të regjistruar në një treg të rregulluar që u nënshtrohet rregullave të publikimit sipas standardeve ndërkombëtare të cilat

sigurojnë transparencë adekuate të informacionit për pronësinë; një përqindje prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër quhet e mjaftueshme për të plotësuar këtë kriter; Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër dhe/apo përqindja prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga personi fizik do të jetë tregues i pronësisë së drejtpërdrejt. Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër ose përqindja prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga një person juridik i cili është nën kontrollin e personit/ve fizik, apo nga disa persona juridik të cilat janë nën kontrollin e një personi/ve fizik do të jetë një tregues i pronësisë së tërthortë;

1.36.1.2. personin fizik i cili përndryshe ushtron kontroll në menaxhmentin e subjektit juridik.

1.36.2. në rastin e personave juridik, pronari përfitues duhet të përfshijë të paktën të tilla si fondacionet, truste dhe marrëveshje ligjore të cilat administrojnë dhe shpërndajnë fonde:

1.36.2.1. kur përfituesit e ardhshëm janë përcaktuar tashmë, personin fizik i cili është përfitues i njëzet e pesë perqind (25%) ose më shumë të pasurisë së marrëveshjes ligjore ose subjekti juridik;

1.36.2.2. kur individët që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose subjekti juridik mbeten për t'u përcaktuar, klasa e personave në interesin kryesor të të cilëve është ngritur ose funksionon marrëveshja ligjore ose subjekti juridik;

1.36.2.3. personin fizik i cili ushtron kontroll mbi njëzet e pesë perqind (25%) ose më tepër të pasurisë së një marrëveshje ligjore ose subjekti juridik;

1.36.3. në rastet e sigurimeve të jetës apo sigurimeve të investimeve të ndërlidhura me biznes, pronarët përfitues të cilët janë të përcaktuar në mënyrë të specifikuar si person fizik, juridik apo marrëveshje ligjore apo të cilët janë të përcaktuar sipas karakteristikave apo klasave.

1.37. **Sekuestrim** - ndalimi i transferit, konvertimit, vendosjes ose lëvizjes së fondeve ose ndonjë prone tjetër mbi bazën e një vendimi të një gjyqi ose autoriteti tjetër kompetent dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tij. Fondet ose pronat e tjera të sekuestruara do të mbeten pronë e personave ose subjekteve që kishin interes në fondet ose pronat e tjera të veçanta në kohën kur u bë sekuestrimi, por do të vazhdojnë të administrohen nga autoriteti kompetent;

1.38. **Subjekt** - personin fizik ose juridik që ekziston në një formë që njihet ligjërisht, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shoqëri tregtare, OJQ, subjekt politik, ndërmarrje shoqërore dhe ndërmarrje publike;

1.39. **Subjekt raportues** - është personi fizik apo juridik siç përcaktohet në nenin 16 të këtij ligji, nga i cili sipas këtij ligji kërkohet që t'i raportojë NjIF-K-së;

1.40. **Shoqëri Tregtare** - ka kuptimin e përkufizuar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë;

1.41. **Të ardhurat nga vepra penale** - çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose përzier çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale;

1.42. **Transaksion** - për qëllime të këtij ligji transaksion nënkupton një marrëdhënie biznesi ose një(1) shkëmbim që përfshin dy(2) ose më shumë palë në një marrëdhënie afariste ku njëra palë është subjekt raportues sipas këtij ligji;

1.43. **Transaksion i rastit** - çfarëdo transaksioni tjetër nga një transaksion i kryer gjatë ushtrimit të një marrëdhënie afariste të krijuar nga një subjekt raportues dhe personit fizik ose juridik;

1.44. **Transfer elektronik** - transaksionin e kryer në emër të personit iniciues, fizik dhe juridik, përmes një institucioni financiar me anë të mjeteve elektronike me qëllim të vënies së një sasive të të hollave në dispozicion të një personi përfitues në një institucion tjetër financiar;

1.45. **Trusti** - është marrëveshje në mirëbesim në të cilën pronësia mbetet tek personi i besuar në emër të përfituesit;

1.46. **Valutë** - monedhë dhe kartëmonedhë që janë në qarkullim si mjet këmbimi. Shuma e përcaktuar në valutën euro në këtë ligj nënkupton vlerën ekuivalente në një valutë tjetër të huaj;

1.47. **Vepër e ndërlidhur penale** - çdo vepër penale e cila gjeneron të ardhura nga vepra penale;

1.48. **Zyrtari i pajtueshmërisë** - drejtor, zyrtar, punëtorë i çfarëdo subjekti raportues të cilët emërohen në formën me shkrim siç përcaktohet në këtë ligj dhe të cilët përgatisin apo përcjellin raporte në pajtim me nenin 26 dhe dispozitat e tjera të këtij ligji;

1.49. **Menaxhmenti i lartë** - një zyrtar apo punonjës me njohuri të mjaftueshme të pastrimit të parave të institucionit dhe ekspozimit ndaj rrezikut për financim të terrorizmit dhe përvojën e mjaftueshme për të marrë vendime që ndikojnë në ekspozimin ndaj rrezikut, dhe nuk ka nevojë, në të gjitha rastet, të jetë një anëtar i bordit të drejtorëve.

### Neni 3

#### Kompetenca e Prokurorisë

1. Veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të përshkruara në nenin 56 dhe 57 të këtij Ligji hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të themeluar me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

2. Veprat tjera penale të përshkruara në këtë ligj hyjnë në kompetencën e prokurorëve të shtetit siç përshkruhet në Ligjin mbi Prokurorin e Shtetit dhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.



## KAPITULLI II

### NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

#### Neni 4

#### Statusi i Njesisë për Inteligjencë Financiare

1. NJIF-K është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.
2. NjIF-K ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit. NjIF-K vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
3. Stafi profesional i NjIF-K nuk janë nëpunës civil. Megjithatë legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj stafit të NjIF-K, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj dhe aktet tjera nënligjore të cilat do të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore të shërbimit civil.
4. Aktet nënligjore për organizimin e brendshëm administrativ dhe çështje tjera administrative të NjIF-K propozohen nga drejtori i NjIF-K dhe aprovohen nga ana e Bordit të NjIF-K.

#### Neni 5

#### Bordi Mbikëqyrës i NjIF-K

1. Bordi Mbikëqyrës i Njesisë për Inteligjencë Financiare (në tekstin e mëtejme Bordi) mbikëqyrë dhe siguron pavarësinë e NjIF-K. Bordi nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatimi kundrejt NjIF-K.
2. Bordi përbëhet nga Ministri i Financave, i cili do të shërbejë në cilësinë e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, ex officio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës dhe Guvernatori i BQK-së.
3. Bordi mban takim sa herë që puna e NjIF-K ta kërkojë këtë, por jo më pak se dy (2) herë në vit.
4. Mbledhjet e Bordit ftohen nga Kryetari i Bordit i cili vendosë për agjendën, marrë parasysh edhe propozimet nga Drejtori i NjIF-K. Mbledhjet poashtu mund të thirren me kërkesën me shkrim të katër (4) anëtarëve të Bordit.
5. Mbledhjet e Bordit thirren duke komunikuar kohën, vendin dhe agjendën e mbledhjes tek të gjithë anëtarët e Bordit të paktën pesë (5) ditë pune përpara datës së caktuar për mbledhje. Në raste urgjente mbledhjet mund të thirren edhe me një paralajmërim më të shkurtër.

#### Neni 6

#### Detyrat dhe kompetencat e Bordit

1. Bordi është i autorizuar të:

- 1.1. rishikojë, miratojë dhe të refuzojë raportet e NjIF-K, të përgatitura sipas paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligji. Nëse Bordi e refuzon këtë raport, ai duhet t'i ofrojë Drejtorit të NjIF-K një letër me shkrim ku shpjegohen qartë dhe në detaje arsyet për një refuzim të tillë;
- 1.2. vëzhgojë dhe vlerësojë në mënyrë periodike performancën e Drejtorit të NjIF-K;
- 1.3. emërojë dhe shkarkojë Drejtorin e NjIF-K;
- 1.4. miratojë rregulloren e organizimit të brendshëm të NjIF-K sipas propozimit të Drejtorit të NjIF-K;
- 1.5. caktojë buxhetin e NjIF-K-së sipas propozimit të Drejtorit të NjIF-K dhe të njëjtin e përcjellë për procedim sipas Ligjit vjetor për buxhet;
- 1.6. kontrollojë dhe vëzhgojë pasurinë e deklaruar nga Drejtori i NjIF-K dhe rastet e konfliktit të interesit në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, për deklarimin e pasurive dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik dhe neneve tjera relevante të legjislacionit në fuqi në Kosovë;
- 1.7. kryejë funksionin e mekanizmit përgjegjës koordinues për përcaktimin e orientimit të politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të bazuar në rreziqet e identifikuara, si dhe për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e këtij ligji. Për këtë qëllim mund të ftojë edhe akterë tjerë nga sektori publik dhe privat;
- 1.8. për qëllime të paragrafit 1.7. të këtij neni, Bordi mund të krijojë grupe pune për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioriteteve afatgjata dhe afatshkurtra.

#### **Neni 7**

#### **Pavarësia operative e NjIF-K**

Bordi nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet operative në proces të NjIF-K.

#### **Neni 8**

#### **Organizimi i Bordit dhe procedurat vendimmarrëse**

1. Kryetari përfaqëson Bordin në publik dhe cakton një(1) zyrtar të Ministrisë së Financave që të shërbejë si Sekretar i Bordit.
2. Bordi merr vendim me anë të shumicës së votave. Bordi ka kuorumin për të marrë vendim nëse të paktën pesë (5) nga anëtarët e tij marrin pjesë në takimin e caktuar dhe lajmëruar në kohë, në kohën kur merret vendimi.
3. Takimet e Bordit udhëhiqen nga Kryetari, apo nga Ministri i Punëve të Brendshme, në mungesë të Kryetarit.

4. Bordi përgatit dhe miraton rregullat dhe procedurat e nevojshme për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të tij.

#### **Neni 9**

##### **Kompetencat e Kryetarit të Bordit**

Kryetari i Bordit është përgjegjës që të kryejë të gjitha funksionet që i janë dhënë me ligj dhe që Bordi i delegon me shkrim, dhe të kryejë punët e zakonshme të Bordit në pajtueshmëri me vendimet dhe udhëzimet e miratuara në kohë nga Bordi.

#### **Neni 10**

##### **Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të NjIF-K kundrejt Bordit**

1. Një (1) herë në vit, Drejtori i NjIF-K i siguron çdo anëtar të Bordit një(1) raport të azhurnuar pesëmbëdhjetë (15) ditë para takimit të Bordit ku përmbledhen vendimet dhe aktivitetet administrative, ekzekutive dhe rregullatore të NjIF-K, dhe të gjitha aspektet e menaxhimit financiar, të hyrat dhe shpenzimet e NjIF-K.

2. Nëse shumica e anëtarëve vendos se ka arsye që të besohet se NjIF-K nuk po vepron ose nuk ka vepruar, në pajtueshmëri me këtë ligj ose akte të tjera nënligjore të aplikuara në Kosovë, Bordi i drejtohet Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës me lëndën përkatëse për mos-pajtueshmëri dhe i kërkon atij që të kryejë auditim. Raporti i auditimit i paraqitet Kuvendit të Kosovës.

3. Drejtori i NjIF-K nuk është i obliguar që të zbulojë ndonjë informacion i cili mund të rrezikojë anën operacionale të punës së NjIF-K.

#### **Neni 11**

##### **Drejtori i NjIF-K**

1. NjIF-K drejtohet nga një Drejtor i cili është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të NjIF-K, në pajtueshmëri me këtë ligj, aktet e brendshme nënligjore dhe ligjet tjera në fuqi.

2. Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave Drejtori i NjIF-K ndihmohet nga Zëvendës Drejtori i NjIF-K. Zëvendës Drejtori i NjIF-K emërohet nga Drejtori i NjIF-K i cili në formë të shkruar i delegon detyra. Procedurat, kriteret dhe çështjet tjera që ndërlidhen me pozitën e Zëvendës Drejtorit të NjIF-K do të përcaktohen me akte nënligjore.

3. Drejtori i NjIF-K emërohet nga Bordi, i cili duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

- 3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 3.2. të jetë person me integritet të lartë morali dhe profesionalizëm;
- 3.3. të jetë i paanshëm, i ndershëm dhe i denjë për kryerjen e funksionit;
- 3.4. të ketë diplomë universitare në fushën e ekonomisë, financave ose drejtësisë;
- 3.5. të ketë të paktën shtatë (7) vjet përvojë në fushën menaxheriale;

3.6. nuk duhet të ketë pasur një pozitë politike në Qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës, autoritete komunale, partitë politike apo sindikata;

3.7. të mos ketë interes direkt ose indirekt në një subjekt raportues; dhe

3.8. të mos ketë konflikt interesi në pajtim me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit.

4. Bordi siguron një proces të hapur dhe transparent të zgjedhjes së drejtorit sipas procedurave të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

5. Asnjë person nuk mund të emërohet ose të mbetet drejtor nëse shpallet fajtor për një veprë penale e cila është e dënueshme me një vendim për burgim prej gjashtë (6) muajsh ose më shumë.

6. Drejtori i NjIF-K konsiderohet "zyrtar" sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

7. Drejtori i NjIF-K emërohet për një mandat tre (3) vjeçar, i cili mund të vazhdohet edhe njëherë nga Bordi.

8. Gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të Drejtorit, Ministria e Financave në koordinim me Sekretarin e Bordit të NjIF-K fillon procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të ri përmes procesit të hapur, publik, të paanshëm dhe transparent të përzgjedhjes dhe intervistimit duke përfshirë:

8.1. publikimin e vendit të lirë të punës në gjuhët zyrtare, me detajet e pozitës, vendndodhjen e tij, përshkrimin e punëve, kohëzgjatjen e kontratës, përshkrimin e shkurtër të kualifikimeve, aftësive, ekspertizës, vetive personale që kërkohen, si dhe një shpjegim të qartë rreth procedurës së aplikimit dhe përzgjedhjes që duhet të ndiqet;

8.2. të siguroarit se procedura e përzgjedhjes është e hapur, ofron konkurrencë, jo-diskriminuese, e drejtë, objektive dhe transparente duke u bazuar në kualifikimet dhe aftësitë të përcaktuara në këtë ligj.

## **Neni 12**

### **Procedurat e zgjedhjes së Drejtorit të NjIF-K**

1. Ministria e Financave, në koordinim me Sekretarin e Bordit të NjIF-K, bën përzgjedhjen paraprake të kandidatëve më të përshtatshëm të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj si dhe bën përzgjedhjen e të paktën dy (2) kandidatëve në listë të ngushtë.

2. Sekretari i Bordit ia përcjellë Bordit listën e ngushtë të kandidatëve së bashku me një(1) raport ku jepen në detaje dhe kriteret mbi të cilat u bë edhe përzgjedhja paraprake.

3. Bordi pas votimit emëron Drejtorin e NjIF-K-së në mesin e kandidatëve që kanë hyrë në listën e ngushtë.

4. Kryetari i Bordit publikon zyrtarisht përzgjedhjen e Drejtorit të NjIF-K.

**Neni 13****Shkarkimi ose pezullimi i Drejtorit të NjIF-K**

1. Drejtori i NjIF-K-së shkarkohet me anë të të njëjtit proces përmes së cilit është emëruar.
2. Drejtori i NjIF-K-së mund të shkarkohet:
  - 2.1. nëse ka kryer vepër penale;
  - 2.2. si rezultat i humbjes së vazhdueshme të aftësive për të kryer punën e tij për një periudhë më shumë se tre (3) muaj;
  - 2.3. nëse zbulohet se e ka shfrytëzuar pozitën në kundërshtim me ligjin ose në një mënyrë të tillë që ka mundur të çojë NjIF-K në një diskreditim ligjor ose publik, për shkak të shkeljeve serioze profesionale apo sjelljeve personale jo të duhura.
3. Drejtori i NjIF-K-në mund të suspendohet:
  - 3.1. nëse nuk kërkon miratim paraprak nga Bordi para se t'i bashkohet një organizate ose grupi;
  - 3.2. nëse dështon në raportim, siç përcaktohet me këtë ligj;
  - 3.3. nëse ka një pozitë tjetër në kohën kur shërben në cilësinë e Drejtorit të NjIF-K-së;
  - 3.4. nëse është përfshirë në çfarëdo veprimi industrial apo në çfarëdo forme të ndalesës kolektive të punës;
  - 3.5. nëse, pa pëlqimin paraprak të Bordit, jep deklarata publike apo komenton rreth punës së NjIF-K, apo në ndonjë rast u ofron informacione personave të paautorizuar rreth të dhënave, dokumenteve, kontakteve, njohurive ose personelit të NjIF-K;
  - 3.6. nëse përpiket që të fitojë apo pranojë çdo të ardhur si përfitime në para ose shërbime të jashtëligjshme për veten e tij ose për të tjerët, përveç atyre që ofrohen në këtë ligj;
  - 3.7. nëse shkel ndonjërin nga dispozitat e këtij neni apo të këtij ligji të cilat poashtu do të konsiderohen shkak për pezullimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas këtij ligji.

**Neni 14****Detyrat dhe kompetencat e NjIF-K**

1. NjIF-K është e autorizuar:
  - 1.1. të marrë dhe analizojë raportet dhe informacionet:
    - 1.1.1. të bëra dhe të ruajtura sipas neneve 16 deri në 33 të këtij ligji;

1.1.2. që i janë ofruar NjIF-K-së nga NjIF-të e vendeve të huaja me funksione të ngjashme, nga gjykatat ose nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, duke përfshirë organizatat ndërqeveritare e ndërkombëtare, organet publike ose qeveritare; dhe

1.1.3. që i janë ofruar vullnetarisht NjIF-K-së në lidhje me dyshimet për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe/ose financimit të terrorizmit.

1.2. të grumbullojë informacione që kanë lidhje me aktivitetet e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale ose financimin e aktiviteteve terroriste dhe që është në dispozicion publik, përfshirë bazën e të dhënave komerciale në dispozicion;

1.3. të kryejë analiza strategjike të informatave që i grumbullon dhe pranon, për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit;

1.4. të kërkojë nga subjektet raportuese të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj. Të dhënat, dokumentet dhe informatat duhet t'i ofrohen brenda afatit kohor të përcaktuar nga NjIF-K;

1.5. të kërkojë nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj dhe qasje në bazat e të dhënave të cilat mbahen nga këto organe. Informatat e tilla duhet t'i ofrohen pa vonesë;

1.6. të krijojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave për të gjitha informacionet e mbledhura ose të pranuar në lidhje me dyshimin për pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale ose financimin e terrorizmit si dhe materiale të tjera të ngjashme relevante për punën e NjIF-K;

1.7. të përpilojë informata, statistika, raporte dhe, duke u bazuar në ato, t'u bëjë rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe personave apo organeve të tjera relevante, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit;

1.8. t'i bëjë publike raportet që do të ndihmojnë në kryerjen e detyrave të saj;

1.9. të organizojë dhe kryejë trajnime të rregullta, përfshirë vetëdijesim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese;

1.10. të shpërndajë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rezultatet që dalin nga analizat dhe çdo raport apo informacion të nevojshëm për autoritetet përkatëse;

1.11. të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj, duke përfshirë por jo kufizuar në:

1.11.1. përdorimin e formave të standardizuara raportuese;

1.11.2. aktet ose transaksionet e dyshimta, përfshirë natyrën e akteve ose transaksioneve të dyshimta për qëllime të këtij ligji, si dhe hartimin e listave të indikatorëve të këtyre akteve dhe transaksioneve;

1.11.3. lirimimin e personave ose subjekteve, apo grup personash ose subjektësh, nga obligimet e raportimit sipas këtij ligji, si dhe metodat për të raportuar lirime të tilla.

1.12. të lëshojë urdhër për moskryerjen e transaksionit në pajtim me këtë ligj apo të kërkojë nga subjektet raportuese të monitorojë llogaritë apo marrëdhënien e biznesit për një periudhë kohore deri në tre (3) muaj; apo për një periudhë shtesë siç përcaktohet nga NjIF-K;

1.13. të mbikëqyrë dhe monitorojë subjektet raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj si dhe me akte nënligjore, urdhrat dhe urdhëresat, që rrjedhin dhe parashihen me këtë ligj, qoftë në terren qoftë në distance;

1.14. të merr pjesë në organizime për bashkëpunim ndërkombëtarë në fushën e parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit;

1.15. të kryejë funksione të tjera në pajtim me këtë ligj.

2. Stafii i NjIF-K-së ruan dhe nuk zbulon asnjë informacion të marrë në kuadër të fushëveprimit të detyrave të tyre, madje edhe pas ndërprerjes së detyrave të tyre brenda NjIF-K. Informacione të tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e ofruara në pajtim me këtë ligj.

3. NjIF-K dhe institucionet e tjera në Kosovë bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, ndihmojnë njëra-tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e zbatueshme. Për këtë qëllim, NjIF-K mund të nënshkruajë marrëveshje apo memorandume mirëkuptimi.

## **Neni 15**

### **Shpalosja, shpërndarja dhe shkëmbimi i informacionit nga NjIF-K**

1. Me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, NjIF-K mund të shpalosë vetëm informacionin si më poshtë tek organet publike apo qeveritare ose tek subjektet raportuese, nëse shpalosja e tillë konsiderohet si e nevojshme nga NjIF-K, apo do t'i shërbente ose do të ndihmonte NjIF-K që të kryejë detyrat e veta:

1.1. çdo të dhënë rreth personit ose subjektit që mund ta identifikojë personin ose subjektin në mënyrë direkte ose indirekte, duke përfshirë por jo edhe duke kufizuar në një emër ose adresë;

1.2. çdo të dhënë identifikuese në lidhje me një transaksion, duke përfshirë por jo edhe kufizuar datën, vendndodhjen, vlerën ose llojin e pronës, numrin e llogarisë ose numrin e transaksionit; dhe

1.3. çdo të dhënë që NjIF-K e konsideron si të nevojshme me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit.

2. Informacioni i referuar në paragrafin 1. të këtij neni dhe rezultati i analizave për të cilat dyshohet për pastrim të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financim të terrorizmit, mund të shpërndahet dhe shkëmbehet me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, nga NjIF-K me:

2.1. autoritetet vendore dhe ato me kompetenca vendore, nëse informacioni i tillë është relevant për hetime në kuadër të kompetencës së tyre;

2.2. organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ndonjë organ jashtë Kosovës me funksion të ngjashëm me NjIF-K.

3. Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet shpalosen nga NjIF-K vetëm për qëllime inteligjence, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime. Ato nuk mund të përdoren si prova përpara një gjykate, përveç nëse miratohen me shkrim nga Drejtori i NjIFK, i cili autorizon një publikim të tillë vetëm atëherë kur nuk ka mundësi të tjera për organet zbatuese të ligjit që të marrin provat përkatëse diku tjetër dhe në mënyrë tjetër.

4. NjIF-K mund të shkëmbejë ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të qasshme, spontanisht ose me anë të kërkesës, me çdo homolog të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që u nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e homologut, dhe brenda kornizës ligjore vendore të secilës palë. Informatat e shkëmbyera përdoren vetëm sipas kërkesës, me pëlqimin paraprak të agjencisë që e ka dhënë informacionin dhe vetëm për qëllime të luftimit të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit. Për këtë qëllim, NjIF-K mund të nënshkruajë marrëveshje apo memorandume mirëkuptimi.

5. NjIF-K mund të refuzojë kërkesën siç parashihet në paragrafin 4. të këtij neni, nëse shkëmbimi i të dhënave të tilla rrezikon apo mund të rrezikojë rrjedhën e procedimit penal në Kosovë dhe njofton me shkrim homologun e huaj kompetent i cili ka parashtruar kërkesën, duke paraqitur arsyet për refuzim.

### KAPITULLI III

#### SUBJEKTET RAPORTUESE DHE DETYRIMET E TYRE LIGJORE

##### Neni 16

##### Subjektet Raportuese

1. Subjekte raportuese për qëllime të këtij ligji janë:

1.1. bankat;

1.2. institucionet financiare;

1.3. kazinotë, përfshirë ato në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit;

1.4. agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme;

1.5. personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë;



1.6. avokatët dhe noterët kur përgatiten, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre rreth aktiviteteve të mëposhtme:

1.6.1. blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme;

1.6.2. menaxhimin e parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit;

1.6.3. menaxhimin e llogarive bankare, kursimeve ose të letrave me vlerë;

1.6.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive; dhe

1.6.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e personave ose marrëveshjeve juridike dhe blerjen e shitjen e subjekteve afariste.

1.7. kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimor;

1.8. trusti dhe ofruesit e shërbimeve që nuk përfshihen në këtë ligj, të cilët i ofrojnë shërbimet e mëposhtme palëve të treta në baza komerciale:

1.8.1. duke vepruar si agjent formimi i personave juridikë;

1.8.2. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si një drejtor ose sekretar i një kompanie, një partner i një partneriteti, apo një pozitë të ngjashme në lidhje me persona të tjerë juridikë;

1.8.3. duke siguruar një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një kompani, partneritet ose ndonjë person a marrëveshje tjetër juridike;

1.8.4. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si administrator i besuar i një trusti të caktuar;

1.8.5. duke vepruar ose caktuar dikë tjetër të veprorë si një aksionar i emëruar për një person tjetër.

1.9. OJQ-të; dhe

1.10. shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar.

#### **Neni 17**

##### **Veprimet dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese**

1. Veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit merren nga të gjitha subjektet raportuese para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies afariste.

2. Veprimet dhe masat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni ndërmerren nga të gjitha

subjektet raportuese. Për këtë qëllim, subjektet raportuese nxjerrin rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, vendosin kontrolle për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe i zbatojnë ato. Këto rregullore, procedura dhe kontrolle përfshijnë, por nuk duhet kufizuar në:

- 2.1. procedurën për kujdesin e duhur ndaj klientit, përfshirë procedurën për identifikimin dhe verifikimin e klientit;
- 2.2. procedurën e raportimit sipas nenit 26 të këtij ligji dhe dërgimit të informacionit, të dhëna, dhe dokumentacionin në NjIF-K;
- 2.3. procedurën për përpunimin ose marrjen e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin apo transaksionin e dyshuar, duke përfshirë masat për ndalimin e veprimeve të mëtejme lidhur me aktin ose transaksionin e dyshuar në pajtim me paragrafin 5. të nenit 26 të këtij ligji;
- 2.4. emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë për të zbatuar detyrimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe sigurimin e kushteve për punën e tyre;
- 2.5. sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve mbi përgjegjësitë e parapara me këtë ligj;
- 2.6. krijimin e organeve adekuate të kontrollit të rregullt të brendshëm për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe funksionin e auditimit për të testuar sistemin e raportimit dhe identifikimit, përveç për subjektet me numër të kufizuar të stafit;
- 2.7. përfshirjen e listës së indikatorëve të hartuar nga NjIF dhe plotësimin e asaj liste me indikatorë sipas fushëveprimit të subjektit raportues, për identifikimin e personave dhe transaksioneve në lidhje me të cilat ka arsye për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit;
- 2.8. procedurën për grumbullimin, mbajtjen, mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave në pajtim me këtë ligj dhe procedurën për parandalimin e qasjes së paautorizuar;
- 2.9. zbatimin e veprimeve dhe masave të tjera në bazë të këtij ligji.

## **Neni 18**

### **Vlerësimi dhe parandalimi i rrezikut**

1. NjIF-K-i siguron në mënyrë periodike dhe koordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për t'i bërë rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuara. Vlerësimi kombëtar i rrezikut ndërmerret së paku çdo tri(3) vite dhe Ministria e Financave nxjerrë akt nënligjor, sipas nenit 66 të këtij ligji, në mënyrë që të përcaktojë procedurat që duhen ndjekur.

2. Të gjitha subjektet raportuese përcaktojnë në mënyrë periodike rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre, vendndodhjes gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes. Vlerësimi i rrezikut u shpërndalet me kërkesë të NjIF-K dhe, për bankat dhe institucionet financiare, edhe BQK-së.

3. Për këtë qëllim, subjektet raportuese identifikojnë dhe vlerësojnë më tej rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që mund të lindin në lidhje me zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat dhe kanalet e reja të shpërndarjes dhe përdorimit të teknologjive të reja dhe atyre në zhvillim për produkte të reja ose ekzistuese para futjes në përdorim të risive për sa i përket produkteve, praktikave të biznesit, kanaleve të shpërndarjes ose përdorimit të teknologjive të reja apo në zhvillim.

4. Për më tepër, të gjitha subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë çdo rreziku të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit në lidhje me produktet apo transaksionet që promovojnë anonimitetin dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e tyre për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

5. Të gjitha subjektet raportuese në mënyrë të vazhdueshme përcaktojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të paraqitur nga klientët e tyre dhe çdo person tjetër për të cilin ofrojnë shërbime financiare dhe profesionale. Kur subjektet raportuese përcaktojnë se rreziku i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është i lartë, marrin masat e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 22, krahas masave të përcaktuara në këtë nen.

6. Të gjitha subjektet raportuese zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar në përputhje me paragrafin 1. të nenit 22 që janë efektive dhe në proporcion me rreziqet e identifikuara për marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me persona fizikë dhe juridikë, përfshirë institucionet financiare nga shtetet që mund të përcaktohen nga NJIF-K, bazuar në masat ndërkombëtare ndaj shteteve të tilla. NJIF-K cakton kundërmasa të duhura, efektive dhe proporcionale për t'u zbatuar kundrejt shteteve të tilla.

## Neni 19

### Kujdesi i duhur ndaj klientit

1. Masat e kujdesit të duhur ndaj klientit të cilat zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese përfshijnë:

1.1. identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme;

1.2. identifikimin e pronarit përfitues dhe/ose të personit ose personave fizikë të cilët kontrollojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi njëzet e pesë përqind (25%) ose më shumë të një personi juridik. Kur subjektet raportuese konsiderojnë se rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit është i lartë, ato marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, në mënyrë që institucioni apo personi që mbulohet nga ky ligj të bindet se ai e di se kush është pronari përfitues, duke përfshirë, sa i përket personave juridikë, trustet dhe marrëveshjet e ngjashme juridike, duke marrë masa adekuate bazuar në rrezik dhe për të kuptuar strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit;

1.3. të kuptuarit dhe marrjen e informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit të tillë që subjektet raportuese mund të zhvillojnë profilin e biznesit dhe rrezikut të klientëve të tyre, si dhe monitorimin e marrëdhënieve të biznesit;

1.4. kryerjen e monitorimit në vazhdimësi të marrëdhënies së biznesit, përfshirë mbikëqyrjen e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kësaj marrëdhënie, për të siguruar që transaksionet të cilat po kryhen janë në pajtim me njohuritë për klientin, profilin e biznesit dhe të rrezikut, përfshirë, aty ku është e nevojshme, burimin e fondeve dhe garantimin që dokumentet, të dhënat ose informacionet mbahen të rifreskuara.

2. Masat e kujdesit të duhur ndaj klientit zbatohen nga të gjitha subjektet raportuese në këto raste:

2.1. kur krijojnë marrëdhënie afariste;

2.2. kur realizojnë transaksione të rastit në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë, apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse është kryer si një transaksion i vetëm ose disa transaksione që janë të ndërlidhura. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi bëhet në momentin kur shuma monetare bëhet e njohur apo pragu është arritur;

2.3. kur ekzistojnë dyshime rreth saktësisë dhe mjaftueshmërisë së të dhënave identifikuese të marra të klientit;

2.4. kur ka dyshim për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

3. Të gjitha subjektet raportuese identifikojnë klientët e tyre të përcaktuar në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni si në vijim:

3.1. një person fizik identifikohet duke paraqitur një dokument zyrtar origjinal që nuk i ka skaduar afati, dokument në të cilin gjendet edhe fotografia e këtij personi. Adresa e personit dhe data e lindjes verifikohen duke paraqitur një dokument ose dokumente të cilat ofrojnë dëshmi;

3.2. Identiteti i një subjekti juridik verifikohet duke paraqitur:

3.2.1. certifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë;

3.2.2. certifikatën e regjistrimit të një OJQ-je të lëshuar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare;

3.2.3. dëshminë e të qenit i regjistruar si parti politike në pajtim me legjislacionin në fuqi;

4. Nëse subjekti nuk është shoqëri tregtare, OJQ apo subjekt politik, subjektet raportuese marrin çfarëdo dokumenti ose dokumente të tjera të cilat mundësojnë verifikimin e identitetit të subjektit, formës ligjore, adresës, drejtorëve, të mirëbesuarve, si dhe dispozitave që rregullojnë autoritetin e agjentëve, zyrtarëve, ose drejtorëve që janë të angazhuar në subjektin në fjalë.

5. Për bizneset e sigurimeve të jetës dhe sigurimet tjera të ndërlidhura me investime, subjektet raportuese, përveç kujdesit të duhur ndaj klientit në përputhje me këtë nen dhe nenin 22 të këtij ligji, identifikojnë përfituesit edhe:

5.1. kur përfituesi identifikohet si person i emëruar fizik ose juridik, subjektet raportuese regjistrojnë emrin e personit;

5.2. kur përfituesi është i përcaktuar bazuar në karakteristika ose klasa ose në ndonjë mënyrë tjetër, subjektet raportuese marrin dhe ruajnë informacion të mjaftueshëm për përfituesit në mënyrë të tillë që subjekti raportues të ketë mundësinë të përcaktojë

identitetin e përfituesit gjatë kohës së pagesës;

5.3. në të dy rastet, verifikojnë identitetet e përfituesve në përputhje me dispozitat e këtij neni gjatë kohës së pagesës;

5.4. kur përfituesi i identifikuar është person juridik ose marrëveshje juridike dhe subjekti raportues vendos se një përfitues i tillë paraqet rrezik të lartë, atëherë subjekti raportues merr masa të arsyeshme për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e pronarit përfitues të përfituesit në kohën e pagesës.

6. Personi i përfshirë në një aktivitet sipas nën-paragrafëve 2.1. dhe 2.2. të këtij neni, si dhe në rastet e specifikuar në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3., dhe 2.6., të nenit 24 të këtij ligji, siguron subjektin raportues, në mënyrë të përcaktuar nga autoriteti mbikëqyrës sektorial, mbi burimin e prejardhjes së fondeve dhe/apo se po vepron:

6.1. në emër të tij ose të saj si pronar dhe mbajtës i të drejtës së pronësisë mbi çdo pronë që i nënshtrohet transaksionit; ose

6.2. si një agjent i autorizuar i një ose më shumë personash ose subjektsh në pajtim me nën-paragrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij neni, pasi të ketë marrë masat e duhura për të verifikuar se secili person ose subjekt është pronari ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit dhe ka mirëbesimin se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronari dhe/ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit.

7. Çdo person që vepron si agjent i autorizuar prezanton dokumentet në pajtim me nën-paragrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij neni për veten e tij dhe për personin ose subjektin që jep autorizimin, si dhe siguron një dokument me anë të të cilit autorizohet për të kryer transaksione në emër të personit ose subjektit.

8. Pavarësisht nga të vepruarit në pajtueshmëri me paragrafët 3. deri në paragrafin 7. të këtij neni, subjekti raportues merr masat e duhura shtesë për të identifikuar çdo person ose subjekt në emër të të cilit personi që përfshihet në një transaksion vepron në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni duke përfshirë edhe pronarin ose mbajtësin e të drejtës së pronësisë.

9. Në rastet kur subjekti raportues nuk mundet të plotësojë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit, pronarit përfitues ose përfituesit të biznesit të sigurimit të jetës dhe investimeve të tjera të ndërlidhura, në përputhje me këtë nen transaksioni nuk duhet të kryhet. Çdo marrëdhënie biznesi duhet të ndërpritet ose të mos fillohet si dhe çdo llogari duhet të mbyllet dhe çfarëdo pronë të kthehet tek burimi i saj. Një veprim i tillë është pa paragjykim për subjektin raportues për të raportuar rrethana të tilla si akte ose transaksione të dyshimta tek NjIF-K-u në pajtim me nën-paragrafin 1.1. të nenit 26 të këtij ligji dhe për të raportuar informata/materiale shtesë në pajtim me paragrafin 2. të nenit 26 të këtij ligji.

10. Në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji, NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësi sektorial specifikon procedurat për zbatimin e kujdesit të duhur ndaj klientit në përputhje me këtë nen dhe nenin 22 të këtij ligji.

## **Neni 20**

### **Mbajtja e shënimeve**

1. Subjektet raportuese mbajnë të gjitha të dhënat për informatat e mbledhura në pajtim me këtë ligj dhe sigurojnë se dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-K-së, si dhe autoriteteve të tjera kompetente:

1.1. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë identitetin e klientit, mbajtëseve të së drejtës së pronës të marra në pajtim me këtë ligj, llogaritë e dosjeve dhe korrespondencën biznesore, për së paku pesë (5) vjetët e fundit, pas përfundimit të marrëdhënies biznesore;

1.2. informacionet e pranuar në përputhje me dispozitat këtij ligji, për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen nga ana e klientëve, dhe raportet me shkrim të krijuara në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, për së paku pesë (5) vjet pas tentimit për ekzekutim ose ekzekutimit të transaksionit;

1.3 kur të dhënat e transaksioneve i referohen një serie transaksionesh të ndërlidhura të kohëpaskohshme, periudha pesëvjeçare (5) e ruajtjes fillon me ekzekutimin e transaksionit të fundit në atë seri;

1.4. kur informacioni për transaksionin lidhet me një raport të dorëzuar në NjIF-K për sa i përket një akti apo transaksioni të dyshimtë, periudha pesë (5) vjeçare fillon nga data e dorëzimit të raportit në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

2. Në rastin e transfereve elektronike, bankat dhe institucionet financiare që kryejnë aktivitete të tilla mbajnë një regjistër të të gjitha informatave përkatëse për sa i përket pagesit dhe që shoqërojnë një transfer, të gjitha informatat e marra për pagesin dhe të gjitha informatat që shoqërojnë një transfer kur ato veprojnë respektivisht si dërgues, ndërmjetës ose institucion përfitues për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e ekzekutimit të transaksionit.

3. Në raste të veçanta të përcaktuara sipas NjIF-K, për qëllime të ushtrimit të kompetencave të saj, NjIF-K mund të zgjasë periudhën pesë (5) vjeçare siç parashihet në këtë nen me urdhër me shkrim për subjektet raportuese në fjalë.

4. Subjektet raportuese sigurojnë masa të nevojshme për të mbrojtur të dhënat nga dëmtimi dhe për të parandaluar qasjen e paautorizuar.

5. Në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji, NjIF-K, BQK ose një mbikëqyrës sektorial specifikojnë procedurat për mbajtjen e shënimeve në përputhje me këtë nen përfshirë ushtrimin e kontrolleve të brendshme për ruajtjen e të dhënave.

## **Neni 21**

### **Funksioni i pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

1. Subjektet raportuese emërojnë zyrtarin e pajtueshmërisë. Në mungesë të tij caktojnë zëvendësin e tij për të kryer veprime dhe ndërmarrë masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji. Përgjashtimisht, për bankat pozita e zëvendësit të zyrtarit të pajtueshmërisë është pozitë e përhershme.

2. Zyrtari i emëruar për pajtueshmëri duhet të jetë i punësuar tek subjekti raportues në pozicion që i mundëson të ushtrojë të gjitha detyrat e përcaktuara në këtë ligj në mënyrë efektive, efikase dhe cilësore dhe duhet të jetë përgjegjës për ndërveprim dhe këmbim të informatave me NjIF-K, dhe në rastin e bankave dhe institucioneve financiare, edhe me BQK-në, si dhe do t'i nënshtrohet detyrimeve të raportimit dhe mbajtjes së shënimeve dhe konfidencialitetit sipas këtij ligji.

3. Funkzioni i pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit funksionon në mënyrë të pandikuar. Ky funksion për bankat udhëhiqet nga një menaxher i lartë dhe është i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera të subjektit raportues dhe për subjektet tjera raportuese me kusht që të ketë kapacitete të mjaftueshme administrative për këtë.

4. Subjektet raportuese i ofrojnë zyrtarit të pajtueshmërisë si në vijim:

4.1. qasje të pakufizuar në të dhëna, informacione dhe dokumentacion të nevojshëm për të kryer detyrat e tij;

4.2. resurse të nevojshme njerëzore, materiale të TI-së dhe burimet tjera të përshtatshme të punës;

4.3. hapësirë të duhur punuese dhe kushtet teknike për një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe të qasshme për zyrtar të pajtueshmërisë;

4.4. trajnim të vazhdueshëm profesional në fushë për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

4.5. zëvendësim gjatë mungesës; dhe

4.6. mbrojtje në lidhje me zbulimin e të dhënave rreth zyrtarit të pajtueshmërisë tek persona të paautorizuar, si dhe mbrojtjen e procedurave të tjera të cilat mund të ndikojnë në kryerjen pa pengesë të detyrave dhe qasjes së paautorizuar në të dhëna.

5. NjIF-K nxjerr akte nënligjore për të përkufizuar kriteret për “i përshtatshëm” dhe “i duhur” për zyrtarë të pajtueshmërisë, kërkesat që duhet t'i përmbush personi për t'u emëruar si zyrtar i pajtueshmërisë si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e funksionit të pajtueshmërisë dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me zbatimin e detyrimeve sipas këtij ligji. Në rastin e bankave dhe institucioneve financiare, këto kriterë përcaktohen në konsultim me BQK-në, dhe në rast se zyrtari i emëruar për pajtueshmëri nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për “i përshtatshëm” dhe “i duhur”, NjIF-K mund të refuzojë emërimin e tij në këtë pozitë.

6. Zëvendësi i zyrtarit të pajtueshmërisë sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të plotësojë të njëjtat kërkesa si ato të zyrtarit të pajtueshmërisë.

7. Zyrtari i pajtueshmërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim me shkrim nga drejtori ose personi përgjegjës në subjektin raportues, ndërsa për bankat dhe institucionet financiare me vendim të Bordit Drejtues ose përgjegjësit ekuivalent sipas ligjit përkatës në kuadër të cilit vepron subjekti raportues. Në rast të shkarkimit të zyrtarit të pajtueshmërisë, subjekti raportues njofton menjëherë NjIF-K, ndërsa bankat dhe institucionet financiare edhe BQK-në, lidhur me vendimin për shkarkim, duke specifikuar arsyet.

8. Të gjitha subjektet raportuese njoftojnë NjIF-K, ndërsa në rastin e bankave dhe institucioneve



financiare edhe BQK-në, për identitetin e zyrtarit të pajtueshmërisë në një afat prej tridhjetë (30) ditëve pas themelimit të subjektit raportues, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, si dhe në vazhdimësi për çfarëdo ndryshimi të zyrtarit të pajtueshmërisë.

## **Neni 22**

### **Kujdesi i duhur i shtuar**

1. Kur subjektet raportuese përcaktojnë, në përputhje me paragrafin 5. të nenit 18 se rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit është ngritur, ata marrin masa të arsyeshme për të mbajtur të azhurnuara informacionet e mbledhura në pajtim me nenin 19, masa për të zvogëluar këto rreziqe dhe zbatojnë masat e nevojshme të kujdesit të duhur të shtuara për të monitoruar profilin e biznesit dhe të rrezikut, duke përfshirë burimin e fondeve, dhe të sigurojnë që të dhënat dhe informacionet e tjera janë mbajtur të azhurnuara. Mbikëqyrësi sektorial mund të nxjerrë udhëzime të detyrueshme në lidhje me këtë në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji.

2. Kur klienti nuk është fizikisht i pranishëm, subjektet raportuese që i nënshtrohen këtij ligji marrin masa adekuate dhe specifike për të mënjanuar rrezikun e lartë duke marrë një ose më shumë nga masat e mëposhtme, krahas masave sipas paragrafit 1. të këtij neni:

2.1. verifikimin e identitetit të klientit përmes dokumenteve, të dhënave, ose informacioneve;

2.2. marrjes së masave shtesë për të verifikuar ose vërtetuar dokumentet e ofruara ose duke kërkuar certifikatë konfirmuese nga banka ose institucioni financiar të cilët përmenden në këtë ligj; dhe

2.3. sigurohet se pagesa e parë për operacione kryhet përmes një llogarie të hapur në emër të klientit në një bankë.

3. Kërkesat për identifikim dhe kujdes të duhur ndaj klientit konsiderohen të përmbushura edhe pa prezencën fizike të klientit, në rastet e mëposhtme:

3.1. nëse klienti tashmë është i identifikuar për sa i përket një marrëdhënie të vazhdueshme me bankën, me kusht që informacioni të jetë i azhurnuar;

3.2. kur veprimet kryhen me anë të sistemit të sigurimit ose ATM-së, përmes korrespondencës ose subjekteve të përfshira në transportin e gjërave me vlerë ose përmes kredit/debit kartelave, transaksione të tilla i ngarkohen pronarit të llogarisë të cilit i përkasin; dhe

3.3. për klientë të dhënat identifikuese të të cilëve ose çdo informacion tjetër, kërkohen në mënyrë private ose publike ose vërtetohen nga certifikatat e kualifikuara që përdoren për të gjeneruar një nënshkrim digjital të shoqëruar me dokumente elektronike;

4. Në rastet e një marrëdhënie bankare me bankat korespodente apo marrëdhënie të ngjashme, që kanë origjinën nga vende të tjera, bankat dhe institucionet financiare, krahas masave sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të:

4.1. të mbledhin informacione të mjaftueshme me qëllim që të kuptojnë plotësisht llojin e biznesit dhe të përcaktojnë, në bazë të regjistrave publik, listave, dokumenteve ose



të dhënave të njohura nga çdokush, reputacionin e tij dhe cilësinë e kontrollit të cilit i nënshtrohet;

4.2. të vlerësojnë cilësinë e kontrolleve të cilave u nënshtrohet subjekti përkatës në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

4.3. të marrin miratimin nga drejtori i përgjithshëm për personin ose punëtorin e tij të caktuar që kryen një funksion ekuivalent përpara se të krijojë një marrëdhënie të re bankare;

4.4. të përcaktojnë me shkrim kushtet e marrëveshjes me institucionin dhe obligimet e tyre përkatëse; dhe

4.5. të sigurojnë se banka dhe institucioni financiar ka verifikuar identitetin e klientëve të cilët kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e përkohshme, të cilat i kanë pëmbushur me përputhshmëri kërkesat për verifikimin adekuat të klientëve kështu që, sipas kërkesës, ndërmjetësi mund të sigurojë të dhëna financiare plotësuese si rezultat i kryerjes së këtyre obligimeve.

5. Subjektet raportuese marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse klientët e tyre, pronarët përfitues dhe përfituesit e bizneseve të sigurimeve të jetës ose investimeve të tjera të ndërlidhura ose, sipas rastit, pronari përfitues i përfituesit (i fundit në kohën e pagesës) janë persona të ekspozuar politikisht vendas, të huaj apo në organizatat ndërkombëtare, siç përcaktohet me këtë ligj. Nëse përcaktimi i tillë rezulton që një klient ose pronari përfitues që është përcaktuar si i tillë të jetë një person i ekspozuar politikisht vendas, i huaj apo organizata ndërkombëtare siç përcaktohet me këtë ligj, atëherë subjektet raportuese duhet, krahas masave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, të marrin masat e mëposhtme në lidhje me klientët dhe pronarët e tyre përfitues:

5.1. të marrin miratimin e një menaxheri të lartë të subjektit raportues për të krijuar apo për të vazhduar marrëdhënien e biznesit, ose për të kryer transaksionin e rastit;

5.2. të marrin masa të përshtatshme për të identifikuar origjinën e pasurisë së klientit dhe origjinën e pasurive të përdorura në marrëdhënie ose transaksion; dhe

5.3. të sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe të forcuar të llogarisë dhe marrëdhënies.

6. Në rastin e përfituesve të sigurimit të jetës, të biznesit apo investimeve të tjera të ndërlidhura ose, kur është e zbatueshme, pronarët përfitues të përfituesit, kur është përcaktuar se ata janë persona të ekspozuar politikisht vendas, të huaj ose në organizatat ndërkombëtare siç përcaktohet në këtë ligj dhe ka rreziqe më të larta të identifikuara, krahas masave të kujdesit të duhur ndaj klientit sipas këtij neni dhe nenit 19, duhet të:

6.1. informojnë një menaxher të lartë të subjektit raportues para pagimit të policës; dhe

6.2. të kryejnë kontroll të shtuar mbi të gjithë marrëdhënien e biznesit dhe mbajtësin e policës, dhe të konsiderojnë raportimin për transaksion të dyshimtë.

7. Ndërmjetësit financiar nuk mund të hapin ose të mirëmbajnë llogaritë korresponduese me një bankë fiktive (guaskë) ose një bankë e cila është e njohur që lejon përdorimin e llogarive të veta nga banka fiktive.

### **Neni 23**

#### **Kujdesi i duhur i thjeshtësuar**

1. Kur subjekti raportues identifikon fusha me rrezik më të ulët, NjIF-K mund të lejojë subjektin raportues të aplikojnë masat e kujdesit të duhur të thjeshtuar ndaj klientit.
2. Para se të kërkojnë përjashtim dhe të aplikojnë masat e kujdesit të duhur të thjeshtuar, subjekte raportuese konstatojnë se marrëdhënia me klientin ose transaksioni paraqet shkallë më të ulët të rrezikut.
3. Subjektet raportuese sigurojnë që do të kryejnë monitorim të mjaftueshëm të transaksioneve apo marrëdhënieve afariste për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta.
4. Gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj rreziqeve lidhur me llojet e klientëve, vendndodhjes gjeografike të shteteve, produkteve të veçanta, shërbimeve, mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes, subjektet raportuese marrin në konsideratë të paktën faktorët e situatave potencialisht me rrezik më të ulët të cilat përcaktohen nga NjIF-K në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorial.
5. NjIF-K në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorial nxjerrë akte nënligjore për subjektet raportuese lidhur me faktorët e rrezikut që merren në konsideratë dhe/ose masat që ndërmerren në situata ku masat e kujdesit të thjeshtuar janë të përshtatshme. Llogari të veçantë merren parasysh sipas natyrës dhe madhësisë së biznesit, dhe ku është e duhur dhe proporcionale, masa të veçanta përcaktohen.
6. BQK nxjerr akte nënligjore në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji për faktorët e rrezikut që merren në konsideratë dhe/ose masat që duhet të ndërmerren në situata ku masat e kujdesit të thjeshtuar janë të përshtatshme, për bankat dhe institucionet financiare.

### **Neni 24**

#### **Detyrimet shtesë të bankave dhe institucioneve financiare**

1. Bankat dhe institucionet financiare nuk mbajnë llogari anonime apo llogari në emra fiktivë.
2. Bankat dhe institucionet financiare përveç obligimeve të parapara në nenin 19 të këtij ligji, verifikojnë identitetin dhe në rastet kur kanë të bëjnë me persona fizikë, verifikojnë edhe datën e lindjes, të të gjithë klientëve kur:
  - 2.1. hapin llogari bankare;
  - 2.2. pranojnë aksione, bono thesari, ose letra të tjera me vlerë për t'i ruajtur në kasafortë;
  - 2.3. ofrojnë lehtësira për depozita të sigurta;
  - 2.4. kryejnë transfer bankar vendor ose ndërkombëtar të fondeve;
  - 2.5. para kryerjes së transaksioneve të rastit; dhe

2.6. angazhohen në çdo transaksion të vetëm apo të ndërlidhur, në para të gatshme, në vlerën prej dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si një transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë kryer nga ose në emër të një personi ose subjekti dhe shuma e përgjithshme prej dhjetë mijë (10.000) euro ose më shumë është bërë në një ditë të vetme.

3. Bankat dhe institucionet financiare i dorëzojnë NjIF-K-së dhe BQK-së politikat dhe procedurat e parapara në nenin 17 të këtij ligji jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas themelimit të bankës ose institucionit financiar dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas aprovimit të ndryshimeve të procedurave të tilla, apo sipas afatit të përcaktuar nga NjIF-K.

4. Bankat dhe institucionet financiare sigurojnë se personat fizikë apo juridikë që veprojnë si degë, filiale apo agjentë në emër të tyre janë të përfshirë në programet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe monitorohen për sa i përket pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji.

5. Bankat dhe institucionet financiare zbatojnë programe në kuadër të grupit që mbulojnë degët e tyre të huaja dhe filialet shumicë në pronësi, kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë politikat dhe procedurat për shkëmbimin e informatave brenda grupit për qëllime të këtij ligji.

6. Bankat dhe institucionet financiare, aktivitetet e të cilave përfshijnë transfere elektronike marrin dhe verifikojnë emrin e plotë, numrin e llogarisë, adresën, ose në mungesë të adresës numrin personal të identifikimit, ose datën dhe vendin e lindjes, duke përfshirë kur është e nevojshme emrin e institucionit financiar, të autorit të transfereve të tilla. Informacioni përfshihet në mesazhin ose formularin e pagesës që shoqëron transferin. Nëse nuk ka numër llogarie, një numër unik referencë e shoqëron transferin.

7. Bankat dhe institucionet financiare ruajnë këtë informacion dhe e transmetojnë atë në momentin kur veprojnë si ndërmjetësues në zinxhirin e pagesave.

8. Mbikëqyrësit sektorial mund të nxjerrë rregullore në lidhje me transferet vendore dhe ndërkombëtare të ekzekutuara si transfere grumbull/blok transfere.

9. Paragrafët 6. dhe 7. të këtij neni nuk zbatohen për transfere të ekzekutuara si rezultat i transaksioneve me kartë krediti ose kartë debiti, me kusht që numri i kartës së kreditit ose kartës së debitit të shoqërojë transferin e rezultuar nga transaksioni, dhe nuk do të zbatohet për transfere midis bankave dhe/ose institucioneve financiare, ku të dy iniciatori dhe përfituesi janë banka apo institucione financiare që veprojnë në emër të tyre.

10. Nëse bankat ose institucionet financiare pranojnë transfere bankare të cilat nuk e përmbajnë informacionin e plotë mbi autorin, ato duhet të marrin masa për të siguruar dhe verifikuar informacionin që mungon nga institucioni që bën porosinë ose përfituesi. Në rast se ata nuk e marrin informacion që mungon, ata refuzojnë pranimin e transferit dhe i raportojnë për këtë NjIF-K-së.

## Neni 25

### Monitorimi special i transaksioneve të veçanta

1. Subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve të ndërlikuara

dhe jashtëzakonisht të mëdha, të cilat nuk kanë qëllime të qarta ekonomike ose ligjore.

2. Subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve me personat, duke përfshirë personat juridikë dhe marrëveshjet juridike dhe institucionet financiare nga ose në vende që nuk i aplikojnë ose i aplikojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare përkatëse për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

3. Subjektet raportuese shqyrtojnë deri në masën e mundshme sfondin dhe qëllimin e transaksioneve të tilla dhe paraqesin me shkrim gjetjet e tyre dhe informacionin specifik në lidhje me transaksionet e referuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, si dhe të identifikojnë të gjitha palët e përfshira. Këto të dhëna ruhen siç përcaktohet në këtë ligj dhe vihet në dispozicion, nëse kjo kërkohet nga NjIF-K-ja, mbikëqyrësit sektorial dhe autoritetet e tjera kompetente.

## Neni 26

### Raportimi tek NjIF-K

1. Të gjitha subjektet raportuese raportojnë tek NjIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NjIF-K, si në vijim:

1.1. të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë; dhe

1.2. të gjitha transaksionet individuale në para të gatshme në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si një transaksion individual nëse subjekti raportues është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën dhjetëmijë (10.000) euro apo në shumë brenda një (1) ditë të vetme.

2. Subjektet raportuese vazhdojnë të raportojnë tek NjIF-K çdo informacion shtesë të rëndësishëm në lidhje me transaksionet që janë siguruar nga subjektet raportuese pas raportimit të përcaktuar me paragrafin 1. të këtij neni, si dhe informata të tjera sipas kërkesës së NjIF-K.

3. NjIF-K mund të përjashtojë transaksione të caktuara ose kategori të transaksioneve nga detyrimet e nën paragrafit 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, ose me kërkesë të shkruar ose me iniciativë të vet, kur transaksionet apo kategoritë e transaksioneve bankare janë rutinore ose i shërbejnë një qëllimi legjitim apo nuk janë në interes të mandatit të NjIF-K.

4. Subjektet raportuese, drejtorët, zyrtarët, punonjësit e përkohshëm apo të përhershëm të subjektit raportues të cilët përgatisin apo transmetojnë raporte në pajtim me këtë ligj, nuk zbulojnë fakte për raportin që është dorëzuar ose është në proces për t'u dorëzuar, nuk e sigurojnë këtë raport, as nuk e komunikojnë ndonjë të dhënë të përfshirë në atë raport apo për atë raport, përfshirë kur një informacion i tillë është duke u përgatitur për t'u raportuar, apo kur hetimet për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë duke ose mund të kryhen, asnjë personi apo subjekti, përfshirë çdo person apo subjekt të përfshirë në transaksionin i cili përfshihet në raport, përveç NjIF-K, pa pasur autorizim me shkrim nga NjIF-K, prokurori publik ose gjykata.

5. Subjekti raportues e njofton NjIF-K para ndërmarrjes së ndonjë veprimi lidhur me aktin ose transaksionin e dyshimtë, përfshirë edhe veprimin sipas paragrafit 9. të nenit 19 të këtij ligji që mund të rezultojë me lëshimin apo transferimin e pasurisë, që i nënshtrohet transaksionit nga

kontrolli i subjektit raportues. Njoftimi mund të bëhet gojarisht, por njoftimi i tillë nuk e anulon detyrimin e dorëzimit të raportit të shkruar në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

6. Pas pranimit të njoftimit, në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni, NjIF-K brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve udhëzon subjektin raportues që të lejojë ekzekutimin e transaksionit apo të kryejë ngrirjen e përkohshme sipas nenit 27 të këtij ligji. Kur NjIF-K nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti raportues vazhdon me ekzekutimin e transaksionit. Udhëzimi i tillë i veprimit në pajtim me këtë nen nuk i komunikohet asnjë personi apo subjekti, përfshirë edhe klientin, pa pëlqimin e NjIF-K.

7. NjIF-K, çdo autoritet hetues, i ndjekjes penale, gjyqësor ose administrativ dhe subjektet raportuese ose personat dhe subjektet e tjera që kanë në posedim informata personale të punonjësve ose zyrtarëve të tjerë të subjekteve raportuese që raportojnë dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit ose që ofrojnë informacione lidhur me këtë, qoftë brenda qoftë tek NjIF-K, në përputhje me këtë ligj duhet të mbrojnë dhe mbajnë konfidenciale informata të tilla personale.

### **Neni 27**

#### **Ngrirja e përkohshme e transaksioneve**

1. NjIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim për subjektet raportuese për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve, nëse vlerëson se ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin që kryen transaksionin, për të cilin informon prokurorinë dhe organet tjera, kompetente në mënyrë që të marrin masa brenda kompetencave të tyre.

2. Drejtori i NjIF-K ose personi i autorizuar mund, në raste urgjente, të japë urdhër gojor për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve i cili do të konfirmohet me shkrim jo më vonë se në ditën pasardhëse të punës.

3. Ngrirja e përkohshme në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni mund të zgjasë për një periudhë maksimale prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i dhënies së urdhrit për ngrirjen e përkohshme të transaksionit. Nëse afati kohor i përmendur në këtë paragraf ndodh gjatë ditëve të pushimit, NjIF-K mund të lëshojë një urdhër për të zgjatuar afatin e tillë kohor edhe për njëzet e katër (24) orë shtesë.

4. Gjatë kohës së ngrirjes së përkohshme të transaksionit, subjektet raportuese i nënshtrohen urdhrit të NjIF-K.

5. Organet kompetente sipas paragrafit 1. të këtij neni ndërmarrin pa vonesë masat brenda kompetencave të tyre për të cilat ata informojnë NjIF-K menjëherë.

6. Nëse NjIF-K vendos brenda kohës së përmendur në paragrafin 3. të këtij neni, se nuk ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim të parave apo financim të terrorizmit, informon subjektin raportues se mund të kryejë transaksionin.

7. Nëse NjIF-K nuk informon subjektin raportues lidhur me rezultatet e veprimeve të saj, brenda afatit të përmendur në paragrafin 3. të këtij neni, subjekti raportues konsiderohet të ketë leje për të ekzekutuar transaksionin.

### **Neni 28**

#### **Ngrirja e përkohshme e transaksionit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë**

1. NjIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve, bazuar në kërkesën me shkrim të arsyetuar të çdo homologu të huaj që kryen funksione të ngjashme me NJIF-K, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe si subjekt i reciprocitetit.
2. Dispozitat e nenit 27 të këtij ligji aplikohen njëjtë si për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
3. NjIF-K mund të refuzojë kërkesën nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse vlerëson se kërkesa e tillë rrezikon hetimet penale në Kosovë apo për shkaqe të sigurisë, dhe njofton me shkrim homologun e huaj kompetent i cili ka parashtruar kërkesën, duke paraqitur arsyet për refuzim.
4. NjIF-K mund të kërkojë nga çdo homolog i huaj që kryen funksione të ngjashme me NjIF-K të urdhërojë ngrirjen e përkohshme të transaksioneve nëse ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin.

### **Neni 29**

#### **Detyrimet specifike të OJQ-ve**

1. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-ve kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga BQK-ja, në llogarinë bankare të hapur në emër të OJQ-së, me përjashtim të asaj që është paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.
2. OJQ-të mund të:
  - 2.1. pranojnë kontribute në para të gatshme në vlerën që nuk tejkalon vlerën prej pesëqind (500) euro apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, nga një burim i vetëm brenda një (1) dite të vetme. Vlera e përgjithshme e kontributit të pranuar sipas këtij paragrafi gjatë vitit nuk tejkalon vlerën prej njëmijë (1.000) euro;
  - 2.2. paguajnë/japin një marrësi të vetëm para të gatshme që nuk tejkalon vlerën prej pesëqind (500) euro apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, brenda një (1) dite të vetme. Vlera e përgjithshme e pagesave sipas këtij paragrafi gjatë vitit nuk duhet të tejkalojë vlerën prej pesëmijë (5.000) euro.
3. OJQ-të ruajnë të dhënat financiare/librat e kontabilitetit të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Këto të dhëna identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, si dhe do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. Dokumentet për të dhënat financiare ruhen pesë (5) vite dhe janë në dispozicion sipas kërkesës së NjIF-K-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
4. OJQ-të i raportojnë NjIF-K, në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit 1.1. të nenit 26 të këtij ligji, të gjitha aktet apo transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur akti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.
5. Me rastin e dorëzimit të raportit vjetor në pajtim me Ligjin përkatës për Lirinë e Asociimit në

Organizatata Joqeveritare, OJQ-ja në raport shpalosë edhe detajet e informatat të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni.

6. Pavarësisht nga cilado dispozitë tjetër ligjore, raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, i vihen në dispozicion NjIF-K me rastin e paraqitjes së kërkesës.

7. Përfaqësuesi i autorizuar sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare parimisht është zyrtar i pajtueshmërisë dhe person kontaktues me NjIF-K, përveç nëse OJQ nuk e përcakton ndryshe me vendim me shkrim ndonjë drejtorë, zyrtarë, punonjës tjetër të OJQ-së dhe njofton zyrtarisht NjIF-K. Përfaqësuesi i autorizuar i cili përgatit ose përcjell raporte në pajtim me këtë ligj është i detyruar nga dispozitat e paragrafit 4. të nenit 26 të këtij ligji.

8. Në përputhje me detyrimet e tyre si subjekte raportuese sipas këtij ligji, anëtarët e Bordit dhe stafi me përgjegjësi në menaxhimin e OJQ-së sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, marrin masa të duhura për të siguruar që OJQ-të nuk do të shfrytëzohen për pastrimin e parave ose si kanale të shpërndarjes së fondeve ose burimeve tek individët apo subjektet e lidhura me grupet ose organizatat terroriste.

9. NjIF-K dhe autoriteti mbikëqyrës sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikat, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji, siç janë të zbatueshme për OJQ në përputhje me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji.

### **Neni 30**

#### **Detyrimet shtesë të kazinove dhe objekteve të tjera të licencuara të lojërave të fatit**

1. Si subjekte raportuese të identifikuar sipas nenit 16 të këtij ligji, kazinotë dhe objektet e tjera të licencuara të lojërave të fatit (më tutje "lojërat e fatit"), dhe si të tilla subjekt i dispozitave të këtij ligji, janë të detyruara të marrin masa specifike për të adresuar rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që janë të natyrshme në ofrimin e shërbimeve të lojërave të fatit, siç parashihet në nenin 18 të këtij ligji.

2. Në përputhje me dispozitat e neneve 19 dhe 22 të këtij ligji, kazinotë dhe lojërat e fatit verifikojnë dhe regjistrojnë në mënyrë të përhershme identitetin e klientit para se të hyjë në një transaksion ose transaksione të shumta ose të ndërlidhura për të shitur, blerë, transferuar, ose shkëmbyer zhetonët, çipat, ose ndonjë dëshmi tjetër të vlerës në shumën prej dymijë (2.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj. Verifikimi dhe regjistrimi i identitetit shtrihet edhe për transaksionet financiare si hapja e një llogarie, duke përfshirë llogarinë e kursimeve, një transfer elektronik ose një shkëmbim i monedhës në shumën prej dymijë (2.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj. Nëse kazinoja dhe lojërat e fatit nuk janë në gjendje për të verifikuar identitetin e një klienti, ato nuk hyjnë në transaksion.

3. Lojërat e fatit nuk angazhohen në ndonjë nga transaksionet në vijim:

3.1. shkëmbimin e të hollave me të holla me një klient, ose me një pranues tjetër në emër të klientit, në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2.000) euro ose më shumë;

3.2. lëshimin e një çeku ose instrumenti tjetër të negociueshëm ndaj një klienti, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në shkëmbim për të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2.000) euro ose më shumë;



3.3. transferimin e fondeve në mënyrë elektronike ose me ndonjë metodë tjetër për një klient, ose tek një pranues tjetër në emër të klientit, në këmbim me të holla në çdo transaksion në të cilën vlera e shkëmbimit është prej dy mijë (2.000) euro ose më shumë.

4. Këto ndalesa nuk i kufizojnë lojërat e fatit nga pagesa e fitimeve të klientit me çek apo instrument tjetër të negociueshëm apo me transferim elektronik nëse çeku, instrumenti i negociueshëm, ose transferi elektronik që është bërë paguhet me urdhër të klientit.

5. Zyrtarët e pajtueshmërisë të kazinove dhe lojërave të fatit të cilët përgatisin ose përcjellin raporte në pajtim me këtë ligj, janë të detyruar nga dispozitat e paragrafit 4. të nenit 26 të këtij ligji.

6. NjIF-K dhe autoriteti mbikëqyrës sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikën, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji siç janë të zbatueshme për kazinot dhe objektet tjera të licencuara të lojërave të fatit në përputhje me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji.

### **Neni 31**

#### **Detyrimet shtesë të avokatëve, noterëve, kontabilistëve, auditorëve dhe këshilltarëve tatimor**

1. Kur avokatët, noterët, kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimorë (më tutje "profesionistët në fjalë") në cilëndo kohë posedojnë me pasuri në emër të klientit apo palës së tretë, profesionisti në fjalë do të:

1.1. mbajë pasurinë në xhirollogarinë, ose në kasafortën e bankës e cila i nënshtrohet mbikëqyrjes së BQK-së, përveç nëse klienti në mënyrë të qartë pajtohet që pasuria të trajtohet ndryshe, ose kur lloji i pasurisë këtë nuk e lejon;

1.2. shënojë në titullin ose përshkrimin e xhirollogarisë se pasuria mbahet në emër të klientit ose klientëve të profesionistit në fjalë;

1.3. në rastin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide, ruajë një shumë në xhirollogari e cila në çdo kohë është baras ose tejkalon shumën e pasurisë së klientit që mbahet nga profesionisti në fjalë; dhe

1.4. mbajë shënime të plota dhe të sakta, të cilat me rastin e kërkesës janë në dispozicion të klientit, duke treguar të gjitha qëndrimet me pasurinë e klientit dhe duke e veçuar pasurinë e klientit nga pasuritë tjera të cilat mbahen nga profesionisti në fjalë.

2. Në përputhje me dispozitat e nën-paragrafit 1.2. të nenit 26 të këtij ligji, çdo profesionist në fjalë i cili, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin, pranon para nga klienti në shumë prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, për një transaksion ose transaksione të ndërlidhura me të, dorëzon raport tek NjIF-K-ja brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga transaksioni i raportueshëm. Transaksioni gjithashtu raportohet nëse profesionisti në fjalë i pranon paratë si ndërmjetësues, pra kur ai tenton të transferojë paratë tek pala e tretë në emër të klientit. Transaksioni nuk do të ndahet në transaksione të shumta për t'iu shmangur raportimit sipas këtij neni.

3. Për qëllime të paragrafit 2. të këtij neni, transaksioni konsiderohet mes tjerash, por nuk është



i kufizuar me:

- 3.1. shitjen e mallrave dhe shërbimeve;
- 3.2. shitjen e pasurisë së patundshme;
- 3.3. shitjen e pasurisë së paprekshme;
- 3.4. qiradhënien e pasurisë së patundshme ose personale;
- 3.5. këmbimin e parave për mjete të tjera monetare, duke përfshirë edhe para të tjera;
- 3.6. pagesën e një borxhi të mëparshëm;
- 3.7. kompensimin e shpenzimeve të paguara;
- 3.8. vazhdimin ose ri-pagesën e huasë; apo
- 3.9. pagesën e taksave në para profesionistit në fjalë për shërbimet.

4. Për qëllime të paragrafit 2. të këtij neni, shprehja “transaksione të ndërlidhura” nënkupton të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej njëzetekatër (24) orëve ose të gjitha transaksionet e kryera në mes të klientit dhe profesionistit në fjalë brenda një periudhe prej më shumë se njëzetekatër (24) orëve, nëse marrësi është në dijeni ose ka arsye të jetë në dijeni se secili transaksion është njëri prej një sërë transaksionesh të ndërlidhura. Pagesat e shumta që i bëhen avokatit për përfaqësim në një rast të vetëm janë transaksione të ndërlidhura.

5. Forma dhe mënyra e raportimit përcaktohet nga NjIF-K-ja dhe përfshin, duke mos u kufizuar, si në vijim:

- 5.1. emrin, adresën dhe të dhëna të tjera identifikuese të përcaktuara nga NjIF-K, të personit apo subjektit nga i cili janë marrë paratë dhe çdo përfaqësuesi në emër të të cilit vepron personi apo subjekti;
- 5.2. shuma e parave të marra;
- 5.3. data dhe lloji i transaksionit; dhe
- 5.4. informacione të tjera, duke përfshirë edhe identifikimin e personit apo të subjektit që e ka dorëzuar raportin siç përcaktohet nga NjIF-K-ja.

6. Përveç rasteve të parapara në paragrafin 7. të këtij neni, dhe në përputhje me dispozitat e nën- paragrafit 1.1. të nenit 26 të këtij ligji, profesionistët në fjalë të angazhuar në aktivitete specifike i raportojnë NjIF-K-së për akte apo transaksione të dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve dhe para ndërmarrjes së veprimeve të mëtejshme lidhur me aktin ose transaksionin e tillë. Në aktivitete specifike përfshihen:

- 6.1. ndihma ose përfaqësimi i klientit apo klientëve në:
  - 6.1.1. blerjen apo shitjen e pasurisë së paluajtshme ose të organizatave të biznesit;
  - 6.1.2. trajtimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose pasurisë tjetër;
  - 6.1.3. hapjen ose menaxhimin e llogarive bankare, librezave të kursimit ose llogarive të letrave me vlerë;

6.1.4. organizimin e kontributeve të nevojshme për krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive;

6.1.5. krijimin, funksionimin ose menaxhimin e kompanive, trusteve ose strukturave të ngjashme.

6.2. të vepruarit në emër të klientit ose për klientin në çfarëdo transaksioni financiar apo transaksion mbi të drejtat në pasurinë e paluajtshme.

7. Avokati nuk jep informacione të cilat i ka marrë nga klienti ose i ka mësuar për klientin, për ta përfaqësuar klientin në procedurë penale apo gjyqësore pa autorizim nga klienti ose me urdhër të gjykatës, përveç nëse avokati me arsye beson se klienti kërkon këshillë ose ndihmë nga avokati për të kryer një vepër penale.

8. Të dhënat e mbledhura në pajtim me këtë nen ruhen në përputhje me dispozitat e nenit 20 të këtij ligji. Shënimet e ruajtura në pajtim me këtë nen ruhen ndaras nga dosjet që përfshijnë të dhëna që i nënshtrohen të drejtës së posaçme avokat-klient.

9. Oda e Avokatëve të Kosovës, Oda e Noterëve të Kosovës dhe Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe çdo shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionistëve në fjalë informojnë anëtarët e tyre mbi procedurat dhe detyrimet e tyre si dhe për sanksionet e këtij ligji në lidhje me profesionistët përkatës.

10. Zyrtarët e pajtueshmërisë tek profesionistët në fjalë të cilët përgatisin ose përcjellin raporte në pajtim me këtë ligj, janë të detyruar nga dispozitat e paragrafit 4. të nenit 26 të këtij ligji.

11. NjIF-K dhe mbikëqyrësi sektorial mund të miratojnë, ndryshojnë ose shfuqizojnë aktet nënligjore në përputhje me politikat, objektivat dhe qëllimet e këtij ligji siç janë të zbatueshme për profesionistët në fjalë në përputhje me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji.

## **Neni 32**

### **Detyrimet shtesë të transaksioneve për pasuritë e paluajtshme**

1. Kur bartja e të drejtave mbi pronën e paluajtshme përfshin një transaksion ose transaksione në një vlerë monetare dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj, secili transaksion duhet të bëhet me anë të urdhërpagesës bankare ose transferit bankar.

2. Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) nuk regjistron transferin e të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme derisa nuk pranon, krahas dokumenteve të tjera që paraqiten në pajtim me ligjin për regjistrimin e transferit, një deklaratë, në mënyrën dhe formën e saktësuar nga NjIF-K e cila vërteton:

2.1. regjistrimin e transferuesit dhe të pranuesit;

2.2. identitetin e secilit prej personave ose subjektit që ka interes financiar dhe i cili është shfrytëzues i pronës që transferohet dhe natyrën e interesit apo statusin e përfituesit;

2.3. çmimin e blerjes dhe mënyrën e pagesës, nëse pagesa bëhet pjesërisht ose tërësisht, duke përfshirë përmes transferit të pronës, përveç në të holla të gatshme një

përshkrim dhe një vlerësim të vlerës së pronës;

2.4. nëse transferi i nënshtrohet paragrafit 1. të këtij neni, numri i llogarisë financiare ose numrat prej të cilëve pagesa ka qenë ose do të debitohet dhe të e cila ka qenë ose do të transferohet dhe emrat nën të cilët mbahen llogaritë.

3. ZKK-ja mban deklaratën së bashku me dokumentet e tjerë që janë të dorëzuara në pajtim me ligjin mbi regjistrimin e transferit. Pos kësaj, ZKK-ja i dërgon në mënyrën dhe formën e specifikuar nga NjIF-K-së kopjet e të gjitha deklaratave të pranuar në baza mujore.

4. Vendimi i ZKK-së për të refuzuar regjistrimin me arsyetimin e bazuar mbi mosrespektimin e këtij neni, bëhet si dhe mund të rishqyrtohet në pajtim me legjislacionin në fuqi mbi themelimin e regjistrimit mbi të drejtat në pronën e paluajtshme.

### Neni 33

#### **Deklarimi i detyruar i qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës**

1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart instrumente monetare në vlerën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë, apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, paraqet me shkrim shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Dogana e Kosovës, para zyrtarit doganor. Nëse kërkohet nga zyrtari doganor, ai i paraqet këto instrumente monetare. Sipas këtij neni, konsiderohet se personi bart instrumente monetare nëse, midis të tjerash, ato janë në posedim fizik të këtij personi apo në automjetin privat, ose në ndonjë mjet transporti tjetër që shfrytëzohet nga ky person. Detyrimi për të deklaruar nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara janë të pasakta apo jo të plota.

2. Secili person i cili nga Kosova dërgon në një vend jashtë Kosovës ose i cili i pranon në Kosovë nga një vend tjetër jashtë Kosovës, përmes postës, ngarkesave kargo apo kuririt komercial, instrumente monetare në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë apo vlerën ekuivalente në valutë të huaj, deklaron me shkrim shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm në një formë e cila përcaktohet nga Dogana e Kosovës, para zyrtarit doganor dhe i paraqet instrumentet monetare nëse këtë e kërkon zyrtari doganor. Personi mund të plotësojë obligimin e tij lidhur me raportimin sipas këtij paragrafi me anë të njoftimit të përmbajtjes së pakos në deklaratën doganore ose në dokumentacionin ndërkombëtar të bagazhit. Detyrimi për të deklaruar nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara janë të pasakta apo jo të plota.

3. Detyrimi për të deklaruar sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara nuk janë të sakta apo nuk janë të plota. Në rast se personi për shumën totale të instrumenteve monetare në posedim nuk mund të ofroj burimin e tyre të verifikueshëm, atëherë zyrtari doganor sekuestron gjithë shumën e instrumenteve monetare në posedim.

4. Dogana e Kosovës i dërgon NjIF-K-së kopjet e të gjitha deklaratave të regjistruara në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, dhe njofton NjIF-K për të gjitha deklaratimet e pasakta apo jo të plota.

5. Personi i cili nuk respekton dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, kryen vepër të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej njëzet e pesë përqind (25 %) të shumës totale të instrumenteve monetare në posedim për të cilat ka detyrim për të deklaruar.

6. Zyrtari doganor i lëshon personit që ka kryer kundërvajtje të tillë një njoftim me shkrim në një formular standard, ku deklarohet natyra e veprës kundërvajtëse dhe gjoba e shqiptuar e cila duhet t'i paguhet Doganës së Kosovës menjëherë.

7. Nëse gjoba e shqiptuar nuk paguhet menjëherë, zyrtari doganor i sekuestron dhe mban njëzet e pesë përqind (25%) të shumës së instrumenteve monetare. Nëse instrumentet monetare nuk janë të ndashme në mënyrën që lejon sekuestrimin dhe mbajtjen e shumës së saktë të mjeteve monetare të cilat duhet të sekuestrohen dhe të mbahen, zyrtari doganor sekuestron shumë më të madhe nga vlera, por sa të jetë e mundur ajo duhet të jetë sa më e përafërt me shumën e tillë.

8. Pas sekuestrimit sipas paragrafit 7. të këtij neni, zyrtari doganor i lëshon personit në fjalë vërtetimin me shkrim ku deklarohen faktet përkatëse, shuma e mjeteve monetare të sekuestruara dhe të mbajtura.

9. Instrumentet monetare të sekuestruara dhe të ruajtura në pajtim me këtë nen, nëse është e mundur ruhen në një llogari të posaçme në emër të Doganës së Kosovës pa kamatë në BQK ose lihen në ruajtje të sigurt në BQK për aq kohë derisa të paguhet gjoba e plotë apo siç është urdhëruar nga gjykata kompetente, përkatësisht në pajtim me procedurën e përcaktuar sipas Ligjit për Kundërvajtje.

10. Gjoba, sekuestrimi ose mbajtja e kryer në përputhje me paragrafët 5. dhe 7. të këtij neni nuk paragjykon ndonjë procedurë penale ndaj personit.

11. Gjoba e shqiptuar në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni ose sekuestrimi apo mbajtja e mjeteve monetare në pajtim me paragrafin 7. të këtij neni mbetet valide dhe në fuqi pavarësisht nga kontestimi i gjobës së tillë, sekuestrimit apo mbajtjes pezull, deri në zgjidhjen e kontestit.

12. Kundër vendimit të sjellë në bazë të këtij neni për kryerje të veprës kundërvajtëse pala ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rishqyrtim të vendimit në Doganë në afat brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit.

13. Dogana e Kosovës merr të gjitha masat e duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe raportojnë tek NJIF-K për çdo akt dhe transaksion të dyshimtë lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit që zbulon gjatë kryerjes së detyrave të saj. Dogana e Kosovës mban lidhje me NJIF-K, prokurorët, policinë dhe organet tjera përkatëse për qëllimin e kryerjes së këtyre detyrave.

14. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, zyrtarët doganor mund të marrin në pyetje dhe të kontrollojnë persona fizikë, bagazhin e tyre dhe mjetet e transportit dhe mund të sekuestrojnë dhe mbajnë instrumentet monetare në përputhje me këtë nen. Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë zbatohen në mënyrë të njëjtë sikurse që zbatohet tek mallrat kur kemi të bëjmë me instrumente monetare.

15. Dogana e Kosovës do të:

15.1. mbajë çfarëdo instrumenti monetar që bartë personi që është duke hyrë apo dalë nga Kosova në vlerë mbi dhjetëmijë (10.000) euro apo në shumë, apo në vlerë ekuivalente në valutë të huaj, dhe të cilat nuk janë deklaruar në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni; dhe

15.2. sekuestron çdo instrument monetar që bartet nga një person që është duke hyrë

apo duke dalë nga Kosova, në qoftë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se instrumentet e tilla monetare janë të ardhura nga krimi, ose janë përdorur ose kanë pasur për qëllim të përdoren për të kryer ose për të lehtësuar pastrimin e parave, veprave të ndërlidhura penale ose janë të ndërlidhura me financimin e terrorizmit, gjithashtu nëse detyrimi për të deklaruar nuk është përmbushur siç përcaktohet në paragrafin 3. të këtij neni.

16. Pas sekuestrimit të paraparë me paragrafin 15. të këtij neni, Dogana e Kosovës i lëshon personit në fjalë njoftim me shkrim ku deklarohet shuma e instrumenteve monetare të sekuestruara dhe të mbajtura, faktet përkatëse, duke specifikuar po ashtu nëse gjoba është zbritur nga shuma e sekuestruar në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni.

17. Me sekuestrimin e instrumenteve monetare në bazë të paragrafit 15. të këtij neni, Dogana e Kosovës, pa vonesë:

17.1. lajmëron prokurorin kompetent për të mundësuar hetime apo veprime të mëtutjeshme, i ofron prokurorit kompetent një kopje të vërtetimit me shkrim cili i është dorëzuar personit në fjalë si dhe të gjitha informatat tjera të kërkuara;

17.2. raporton për këtë çështje tek NJIF-K.

18. Instrumentet monetare të sekuestruara dhe të mbajtura nga Dogana e Kosovës në përputhje me këtë nen, kur është e mundur, ruhen në një llogari të veçantë pa kamatë në emër të BQK-së. Përndryshe, mbahen në kujdestari të sigurt në BQK derisa gjoba nuk paguhet plotësisht ose siç mund të urdhërohet ndryshe nga një gjykatë kompetente ose siç parashihet ndryshe me këtë ligj.

19. Kur instrumentet monetare janë sekuestruar në pajtim me paragrafin 15. të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve nga njoftimi sipas paragrafit 17. të këtij neni, prokurori:

19.1. paraqet një kërkesë për konfiskimin e instrumenteve monetare;

19.2. paraqet një kërkesë për masa të përkohshme të sigurimit të instrumenteve monetare; apo

19.3. njofton me shkrim personin në fjalë, Doganën e Kosovës dhe NJIF-K se asnjë veprim nuk do të ndërmerret në lidhje me pasurinë e sekuestruar dhe se personi në fjalë mund të aplikojë për kthim të instrumenteve monetare në përputhje me paragrafin 20. të këtij neni.

20. Nëse prokurori jep njoftim sipas nën-paragrafit 19.3 të këtij neni, se asnjë veprim nuk do të ndërmerret në lidhje me instrumentet monetare të sekuestruara, Dogana e Kosovës ia kthen instrumentet monetare personit në fjalë, pas aplikimit nga ana e tyre.

21. Në qoftë se personi në fjalë nuk është në gjendje të merr personalisht instrumentet monetare, atëherë mund të:

21.1. japë autorizim një personi tjetër me anë të të cilit ky person autorizohet që të marrë instrumentet e sekuestruara monetare në emër të tij dhe/apo t'i ofrojë organit kompetent një dokument me shkrim, të nënshkruar dhe të noterizuar duke udhëzuar autoritetin e tillë t'i kthejë instrumentet monetare një individi tjetër të cekur; ose

21.2. dorëzojë një kërkesë me shkrim drejtuar BQK-së, për të depozituar instrumentet monetare në një llogari të veçantë të Doganës së Kosovës në emër të personit të tillë, deri në kohën kur instrumentet monetare të jenë marrë personalisht nga personi në fjalë ose nga një person i autorizuar për ta bërë këtë në përputhje me nën-paragrafin 21.1. të këtij paragrafi.

22. Në qoftë se nuk është bërë kërkesë për kthim të instrumenteve monetare në përputhje me nën-paragrafin 21.1. të këtij neni ose instrumentet monetare nuk janë marrë brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e mbylljes së procedurës së përcaktuar në këtë nen, instrumentet monetare merren përfundimisht nga Doganat e Kosovës dhe depozitohen në Buxhetin e Kosovës.

23. Në kuadër të detyrave të tyre dhe posaçërisht kur veprojnë në pajtim me paragrafit 15. të këtij neni, zyrtarët doganorë mund të ndalojnë dhe arrestojnë një person nën kushtet e përshkruara në nenin 100 të Kodit të Procedurës Penale.

#### **KAPITULLI IV MBIKËQYRJA E PAJTUESHMËRISË**

##### **Neni 34 Mbikëqyrja e Pajtushmërisë**

1. Mbikëqyrja e pajtushmërisë është vlerësimi i përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e subjekteve raportuese në pajtim me këtë ligj.

2. Mbikëqyrja e pajtushmërisë kryhet:

2.1. si inspektim në vendin e subjektit raportues; apo

2.2. si mbikëqyrje nga distanca e subjektit raportues.

3. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial kryejnë mbikëqyrjen e pajtushmërisë sipas dispozitave të këtij ligji gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera përkatëse.

4. BQK kryen mbikëqyrjen e pajtushmërisë për subjektet raportuese në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të nenit 16 të këtij ligji, sipas kompetencave të dhëna me këtë ligj.

5. NjIF-K, për qëllime të dhënies së efektit të dispozitave të paragrafit 3. të këtij neni për mbikëqyrësit e tjerë sektorial, hyn në marrëveshje specifike individuale me shkrim me qëllim të krijimit të kompetencës mbikëqyrëse dhe përgjegjësi, procedurave dhe bashkëpunimit përkatës.

6. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial marrin parasysh rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit në sektorin në të cilin vepron subjekti raportues edhe gjatë marrjes në konsiderim të miratimit, ripërtëritjes apo refuzimit të licencës apo autorizimit tjetër të domosdoshëm për subjektin raportues që të veprojë siç kërkohet nga ky ligj dhe ligjet e tjera.

7. Pas mbikëqyrjes së pajtushmërisë NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial ashtu siç përcaktohet në këtë ligj mund të:

- 7.1. rekomandojnë masat përmirësuese;
- 7.2. shqiptojnë ndëshkim administrativ; apo
- 7.3. procedojnë çështjen në procedurë penale.

### **Neni 35**

#### **Inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga NjIF-K**

1. Për subjektet raportuese të përcaktuara nga nën-paragrafi 1.3. deri nën paragrafin 1.10. të nenit 16 të këtij ligji, një zyrtar ose zyrtarët e NjIF-K të cilët janë të autorizuar nga Drejtori i NjIF-K për këtë qëllim (në tekstin e mëtejshëm “një zyrtar i autorizuar ose zyrtarët”), mund, në çdo kohë gjatë orarit të rregullt të punës, me paralajmërim apo pa paralajmërim, të hyjë në çfarëdo ndërtese tjetër përveç se në një shtëpi banimi ose banesë, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se aty mbahen shënime të cilat ruhen në pajtim me dispozitat nga neni 16 deri të neni 32 të këtij ligji ose dokumentet relevante për të përcaktuar nëse detyrimet sipas dispozitave nga neni 16 deri të neni 32 të këtij ligji janë përmbushur.

2. Për qëllime të paragrafit 1. të këtij neni, zyrtari ose zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë dhe të inspektojnë shënime ose dokumentet, kopjojnë ose të riprodhojnë çdo shënim të tillë ose dokument dhe të bëjnë pyetje për të gjetur dhe për të kuptuar shënime ose dokumentet e tilla. Zyrtari ose zyrtarët e autorizuar kufizojnë inspektimin në ato pjesë të objekteve në të cilat janë të dhënat ose dokumentet përkatëse dhe ka arsye dhe gjasa për t'u gjetur dhe ata kryejnë vetëm veprime të cilat janë të nevojshme për, dhe proporcionale me qëllimet e inspektimit të shënimeve të tilla.

3. NjIF-K mund të kryej inspektime të pajtueshmërisë në vend duke zbatuar kompetencat e dhëna me këtë ligj edhe tek subjektet raportuese të përcaktuara në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të nenit 16 të këtij ligji, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së këtyre subjekteve raportuese me nenin 18 dhe nenin 26 të këtij ligji.

4. Pronari ose personi përgjegjës i objekteve që inspektohen dhe çdo person i pranishëm në këto ambiente i japin zyrtarëve të autorizuar të gjithë ndihmën e arsyeshme për t'iu mundësuar atyre të kryejnë përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë identifikimin e shënimeve apo dokumenteve relevante dhe t'i furnizojnë ata me çdo informacion të kërkuar për t'iu mundësuar zyrtarët e autorizuar të gjejnë dhe kuptojnë shënime ose dokumentet e tilla. Personat e tillë gjithashtu ndihmojnë zyrtarët e autorizuar të kenë qasje dhe t'i kopjojnë apo riprodhojnë shënime dhe dokumentet që mirëmbahen në mënyrë elektronike dhe lejojnë përdorimin e çdo pajisjeje për kopjim të vendosur në objekt.

5. Personi në ndërtesat që janë subjekt i një inspektimi mund të refuzojë të lejojë inspektimin ose kopjimin e një shënimi ose dokumenti nëse vlerëson se:

5.1. nuk është i mbajtur në përputhje me dispozitat nga neni 16 deri të neni 32 të këtij ligji, dhe nuk është relevante për të përcaktuar nëse detyrimet sipas dispozitave nga neni 16 deri të neni 32 të këtij ligji janë përmbushur; ose

5.2. përmban informacion që është subjekt i privilegjit avokat-klient.

6. Në rast të një refuzimi të tillë, një zyrtar i autorizuar që kryen inspektimin vendos shënimin apo dokumentin e kontestuar në një zarf ose kuti tjetër të përshtatshme, e cila mbyllet në prani të personit apo përfaqësuesit të tij, dhe do të firmoset nga zyrtari dhe personi/përfaqësuesi. Shënimin apo dokumentin e mbyllur paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve para një gjykatësi të



procedurës paraprake të gjykatës kompetente, i cili do të inspektojë atë, dhe të përcaktojë nëse ai, apo ndonjë pjesë e tij, i nënshtrohet inspektimit dhe kopjimit sipas këtij neni.

7. Në qoftë se një person mendon se ka qenë subjekt i inspektimit të paligjshëm, mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve që nga dita e inspektimit të gjykatësi i procedurës paraprake të gjykatës kompetente, i cili gjykon ligjshmërinë e veprimeve të përmendura në ankesë dhe vendosë për kompensim kur është e përshtatshme. Zyrtarët e autorizuar të NjIF-K sigurojnë për gjykatësit hetues dokumente të tilla të kërkuara dhe sipas kërkesës, ofrojnë dëshmi gojore.

### **Neni 36**

#### **Inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial**

1. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial me mandat mbikëqyrës sipas paragrafëve 4. dhe 5. të nenit 34, për qëllime të mbikëqyrjes së subjekteve raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregullat dhe rregulloret përkatëse, zbatojnë kompetenca të tilla të mbikëqyrjes së kujdesit ashtu si iu janë dhënë me ligjin përkatës, në mënyrë që të jenë të zbatueshme në përmbushjen e mandatit të tyre mbikëqyrës sipas këtij ligji, me përjashtim të kompetencës për mbikëqyrje të subjekteve raportuese për sa i përket pajtueshmërisë lidhur me obligimet e përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji.

2. Aty ku kompetenca të tilla mbikëqyrëse nuk janë të parashikuara nga ligji i veçantë, zbatohen dispozitat e kompetencave mbikëqyrëse të NjIF-K-it të përcaktuara në paragrafët 2,4,5,6 dhe 7 në nenin 35 të këtij ligji.

### **Neni 37**

#### **Mbikëqyrja nga distanca**

1. Për qëllime të monitorimit dhe mbikëqyrjes nga distanca të subjekteve raportuese për vlerësimin e pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji ose çfarëdo rregulle ose rregulloreje të nxjerrë në përputhje me këtë ligj, NjIF-K dhe BQK mund përmes një njoftimi me shkrim të dërguar subjektit raportues, të kërkojnë që subjekti raportues të paraqesë, brenda kohës dhe në mënyrën e specifikuar në atë njoftim, çfarëdo dokumentacioni, përfshirë ato të lidhura me procedurat e brendshme sipas këtij ligji ose çfarëdo rregulloreje për të përmbushur përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji, dhe dispozitat e paragrafëve 3,4 dhe 5 të nenit 35 zbatohen në përputhje me situatën.

2. Mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të kryejnë mbikëqyrje nga distanca, nëse kjo kompetencë i është dhënë në pajtim me paragrafin 5. të nenit 34.

### **Neni 38**

#### **Bashkëpunimi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë**

1. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre për mbikëqyrje të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji në lidhje me:

1.1. planifikimin dhe implementimin e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;

1.2. aktivitetet e përbashkëta të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në vend dhe në distancë;



1.3. dokumentacionin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;

1.4. ndëshkimin administrativ dhe masat e tjera mbikëqyrëse; dhe

1.5. vlerësimin dhe aktivitetet pasuese të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë.

2. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, kur gjatë kryerjes së detyrave brenda kompetencave të tyre dyshojnë apo identifikojnë aktivitete që janë ose mund të jenë të lidhura me pastrimin e parave dhe financim të terrorizmit, informojë menjëherë me shkrim NjIF-K.

3. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, informojë me shkrim NjIF-K për të gjitha masat e marra për zbatimin e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë dhe t'i dërgojë NjIF-K një kopje të çdo raporti që ata i lëshojnë subjektit raportues, jo më vonë se tri (3) ditë nga data e lëshimit të tyre.

### **Neni 39**

#### **Të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë**

1. NjIF-K, BQK, mbikëqyrësit e tjerë sektorial me të cilët NjIF-K ka hyrë në marrëveshje specifike individuale sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, autoritetet e tjera kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.

2. Në mbajtjen e të dhënave statistikore, personat, subjektet dhe autoritetet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni ndërveprojnë me NjIF-K e cila, në bashkëpunim me BQK ose mbikëqyrësit e tjerë sektorial, sipas rastit, mund të përcaktojë llojin e të dhënave statistikore që mund të kërkohen.

3. Për këtë qëllim, NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësi sektorial, nxjerrin akte nënligjore, urdhra ose udhëzime për mbajtjen e statistikave të atyre sektorëve nën fushëveprimin e tyre mbikëqyrës në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66.

4. Të dhënat statistikore të mbajtura sipas këtij neni vihen në dispozicion të NjIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara prej NjIF-K, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet sipas nenit 14 të këtij ligji.

5. NjIF-K do të njoftojë subjektet raportuese, që kanë raportuar në NjIF-K një person ose transaksion në lidhje me të cilën ka pasur arsye për të dyshuar për pastrim parash apo financim të terrorizmit, lidhur me rezultatet të sjella nga raportimi i tyre.

6. Njoftimi i përmendur në paragrafin 5. të këtij neni do të aplikohet për:

6.1. të dhënat për numrin e raporteve të dërguara për transaksionet ose personave për të cilat ka arsye për të dyshuar lidhur me pastrimin e parave ose financim të terrorizmit;

6.2. rezultatet e sjella nga raportimi i tillë, kur është e aplikueshme;

6.3. informatat për trendët dhe teknikat lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

7. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial sipas këtij neni bashkëpunojnë për qëllime të përmbushjes së përgjegjësisë të tyre nën këtë nen.

## **KAPITULLI V**

### **NDËSHKIMET ADMINISTRATIVE DHE MASA PËR PËRMIRËSIM**

#### **Neni 40**

##### **Ndëshkimet Administrative**

Dështimi nga subjektet raportuese të definuar në nenin 16 të këtij ligji, për t'iu përmbajtur obligimeve ligjore të parashikuara në këtë ligj, që nuk janë vepra penale, përbëjnë shkelje administrative të cilat klasifikohen si shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.

#### **Neni 41**

##### **Shkelje shumë të rënda**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim do të përbëjnë shkelje shumë të rënda:

1.1. dështimi për të përmbushur detyrimet e raportimit të përcaktuara në nenin 26;

1.2. dështimi për të përmbushur detyrimin për të bashkëpunuar në bazë të nën-paragrafit 1.4. të nenit 14 pas kërkesës zyrtare me shkrim nga NjIF-K;

1.3. dështimi për të përmbushur detyrimet e nën-paragrafit 1.12. të nenit 14;

1.4. dështimi në përputhje me detyrimin për të ndërmarrë veprime përmirësuese sipas rekomandimit zyrtar të NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësve të tjerë sektorial të lëshuar pas mbikëqyrjes së pajtueshmërisë siç definohet në nenin 34 në rast të mosgatishmërisë për të përmbushur rekomandimin;

1.5. përsëritja e shkeljes së rëndë për të cilën subjektit raportues i është shqiptuar sanksion administrativ gjatë pesë (5) vjetëve të fundit për të njëjtin lloj të shkeljes; dhe

1.6. shkelje të detyrimit për të ngrirë ose të bllokuar fondet siç përcaktohet në nenin 27.

#### **Neni 42**

##### **Ndëshkimet për shkeljet shumë të rënda**

1. Për shkeljet shumë të rënda të përcaktuara në nenin 41, NjIF-K mund të shqiptojë ndëshkim administrativ siç definohet në vijim:

1.1. vërejtje publike;

1.2. gjobë në shumën prej:

1.2.1. në një minimum prej pesëdhjetëmijë (50.000) euro;

1.2.2. një shumë maksimale që mund të vendoset deri në lartësinë më të madhe të këtyre shifrave: dhjetë përqind (10%) të vlerës neto të subjektit raportues, sipas

llogarive më të fundit në dispozicion të aprovuara nga bordi menaxhues, por jo më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) euro;

1.2.3. dy(2) herë vëllimin ekonomik të transaksionit, por jo më pak se pesëdhjetëmijë (50.000) euro;

1.2.4. deri në treqind e pesëdhjetëmijë (350.000) euro; apo

1.2.5. deri në shtatëqindmijë (700.000) euro, për bankat dhe institucionet financiare.

1.3. në rastin e institucioneve që kërkohet licencë, certifikatë apo çfarëdo autorizimi administrativ për funksionimin e tyre, mund të kërkohet tërheqja e licencës, certifikatës apo autorizimit. Ndëshkimi i paraparë në nën-paragrafin 1.2. të këtij neni, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, vendosen në të njëjtën kohë me një nga ato të listuara në nën-paragrafin 1.1. dhe në nën-paragrafin 1.3. të këtij neni.

2. Përveç ndëshkimit të zbatueshëm që shqiptohet për subjektin raportues për shkeljet shumë të rënda, një ose më shumë nga ndëshkimet e mëposhtme mund të shqiptohet për personat fizik që janë përgjegjës për shkeljen dhe që mbajnë poste administrative apo menaxhuese në subjektin raportues:

2.1. gjobë për secilin prej tyre prej dhjetëmijë (10.000) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro;

2.2. largimi nga detyra, me diskualifikimin nga mbajtja e pozitave administrative apo menaxhuese në të njëjtin subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh;

2.3. largimi nga detyra me diskualifikimin nga mbajtja administrative apo menaxhim në pozicionet në çdo subjekt raportues për një periudhë maksimale prej dhjetë (10) vjetësh.

3. Ndëshkimi i paraparë në nën-paragrafin 2.1. të këtij neni, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, mund të shqiptohet në të njëjtën kohë me një nga ato të listuara në nën-paragrafët 2.2. dhe 2.3. të këtij neni.

### **Neni 43**

#### **Shkelje të rënda**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim paraqesin shkelje të rënda:

1.1. dështimi në përputhje me detyrimin që të nxirren politika dhe procedura të brendshme të shkruara në vendosjen kontrolleve për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në zbatimin e tyre siç përcaktohet në nenin 17 të këtij ligji;

1.2. mospërbushja e obligimeve formale të identifikimit, siç përcaktohet në nenin 19 të këtij ligji;

1.3. dështimi për të përmbushur detyrimet për të identifikuar pronarin përfitues, siç përcaktohet në nën-paragrafin 1.2. të nenit 19 të këtij ligji;

- 1.4. dështimi në përputhje me detyrimin e marrjes së informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit siç përcaktohet në nën-paragrafin 1.3. të nenit 19 të këtij ligji;
- 1.5. dështimi në përputhje me detyrimin e zbatimit të masave për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit, sipas kushteve të nën-paragrafit 1.4. të nenit 19 të këtij ligji;
- 1.6. dështimi për të përmbushur detyrimin e aplikimit të masave të kujdesit të duhur për klientët ekzistues siç përcaktohet në dispozitat kalimtare, sipas paragrafit 1. të nenit 68 të këtij ligji;
- 1.7. mospërmbushja e detyrimit të aplikimit të masave të kujdesit të duhur të shtuar, siç përcaktohet në nenin 22 të këtij ligji;
- 1.8. mospërmbushja e detyrimit të monitorimit special të transaksioneve të veçanta, siç përcaktohet në neni 25 të këtij ligji;
- 1.9. dështimi në përputhje me detyrimin e vlerësimit të rrezikut, siç përcaktohet në nenin 18 të këtij ligji;
- 1.10. dështimi në përputhje me detyrimin e raportimit tek NjIF-K, siç përcaktohet në paragrafin 9. të nenit 19 të këtij ligji;
- 1.11. dështimi në përputhje me detyrimin e raportimit, siç përcaktohet në paragrafin 3. të nenit 25 të këtij ligji;
- 1.12. dështimi për të përmbushur detyrimin e bashkëpunimit në bazë të paragrafit 4. të nenit 35 të këtij ligji pas njoftimit zyrtar me shkrim nga NjIF-K, BQK ose mbikëqyrësit e tjerë sektorial;
- 1.13. mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 20 të këtij ligji;
- 1.14. dështimi në përputhje me detyrimin e krijimit të organeve adekuate të kontrollit për implementimin e obligimeve të cilat dalin nga ky ligj dhe testimin e sistemit të raportimit dhe identifikimit, siç përcaktohet në nën- paragrafin 2.6. të neni 17 të këtij ligji;
- 1.15. mosrespektimi i detyrimeve mbi marrjen e informacionit mbi pagesat për transferet elektronike siç përcaktohet në nenin 24 të këtij ligji;
- 1.16. dështimi në përputhje me detyrimin e njoftimit të NjIF-K për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë të subjektit raportues ose zëvendësit të tij, ose refuzimit për të adresuar kundërshtimet ose vërejtjet e bëra sipas kushteve të nenit 21 të këtij ligji;
- 1.17. dështimi në përputhje me detyrimin për të siguruar zyrtarit të pajtueshmërisë kushtet e nevojshme për ushtrimin e funksionit, siç përcaktohet në paragrafin 4. të nenit 21 të këtij ligji;
- 1.18. dështimi në përputhje me detyrimin e trajnimit të punonjësve, sipas nën-paragrafit

2.5. të nenit 17 të këtij ligji;

1.19. dështimi në përputhje me detyrimin e miratimit dhe vënies në dispozicion të NjIF-K politikat dhe procedurat e duhura dhe të përditësuara për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, siç përcaktohet në paragrafin 3. të nenit 24 të këtij ligji;

1.20. dështimi në përputhje me detyrimin e aplikimit të masave në lidhje me degët dhe filialet shumicë në pronësi të vendosura në vende të treta, siç përcaktohet në nenin 24 të këtij ligji;

1.21. dështimi në përputhje me detyrimin për të ndërmarrë masa për përmirësim pas njoftimit zyrtar të përcaktuar në nën-paragrafin 7.1. të nenit 34 të këtij ligji, kur ka mosgatishmëri për të përmbushur rekomandimet;

1.22. hyrja ose vazhdimi i marrëdhënies së biznesit apo ekzekutimi i pagesave dhe transaksioneve të ndaluara sipas këtij ligji;

1.23. rezistenca ose pengimi i inspektimeve, kur nuk ka njoftim dhe kërkesë paraprake me shkrim nga zyrtarët e autorizuar për të inspektuar, siç përcaktohet në paragrafin 1. të nenit 35 të këtij ligji;

1.24. dështimi nga OJQ-të që të përmbushin detyrimet sipas nenit 29 të këtij ligji; dhe

1.25. përsëritja e shkeljes së lehtë për të cilën subjektit raportues i është shqiptuar sanksion administrativ gjatë tri (3) viteve të fundit për të njëjtin lloj të shkeljes.

2. Përveç nëse ka indikatorë apo dyshim për pastrim të parave apo financimit të terrorizmit, shkeljet e përshkruara në nën-paragrafët 1.1., 1.2., 1.3., 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.13., të këtij neni, mund të klasifikohen si shkelje të lehta, kur shkelja e bërë nga institucioni ose personi përgjegjës sipas këtij ligji mund të konsiderohen kryesisht si shkelje të rastit që mund të jenë të zakonshme dhe të izoluar në bazë të përqindjes së incidenteve në mostrën e pajtueshmërisë.

#### **Neni 44**

##### **Ndëshkimet për shkelje të rënda**

1. Për shkelje të rënda të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, NjIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, mund të shqiptojë ndëshkim administrativ siç definohet në vijim, përveç nëse është parashikuar një ndëshkim më i rëndë sipas nenit 41 të këtij ligji:

1.1. vërejtje private.

1.2. gjobë:

1.2.1. në një minimum prej njëzetmijë (20.000) euro;

1.2.2. një shumë maksimale që mund të vendoset deri në pesë përqind (5%) të vlerës neto të subjektit raportues sipas llogarive më të fundit në dispozicion të aprovuara nga bordi menaxhues, por jo më pak se njëzetmijë (20.000) euro;

1.2.3. shuma e vëllimit ekonomik të transaksionit plus pesëdhjetë perqind (50 %) të asaj vlere; por jo më pak se njëzetmijë (20.000) euro; apo

1.2.4. tridhjetëmijë (30.000) euro.

1.3. ndëshkimi i parashikuar në nën-paragrafët 1.2., 1.2.1., 1.2.2, 1.2.3. dhe 1.2.4 të këtij paragrafi i cili është i detyrueshëm në të gjitha rastet, mund të vendoset në të njëjtën kohë me ndëshkimin e paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi.

2. Përveç ndëshkimit të zbatueshëm që shqiptohet për subjektin raportues për shkelje të rënda, një(1) ose më shumë nga dënimet e mëposhtme mund të shqiptohet mbi ata që janë përgjegjës për shkeljen dhe mbajnë poste administrative apo menaxhuese në subjektin raportues:

2.1. vërejtje private;

2.2. vërejtje publike;

2.3. gjobë për secilin prej tyre prej njëmijë (1.000) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro;

2.4. pezullim i përkohshëm nga detyra për një periudhë që nuk kalon një (1) vit. Dënimi i parashikuar në këtë nën- paragraf, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, do të vendosen në të njëjtën kohë me një nga ato të listuara në nën-paragrafët 2.1, 2.2. dhe 2.4. të këtij paragrafi.

#### **Neni 45**

##### **Shkeljet e lehta**

Dështimi për të përmbushur detyrimet e specifikuar në këtë ligj dhe që nuk përbëjnë shkelje shumë të rënda ose shkelje të rënda, përbëjnë shkelje të lehtë.

#### **Neni 46**

##### **Ndëshkimet për shkelje të lehta**

1. Për shkelje të lehta NjIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, mund të shqiptojnë:

1.1. vërejtje private;

1.2. gjobë deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro; dhe

1.3. rekomandime për veprime përmirësuese.

#### **Neni 47**

##### **Përgjegjësia administrative e drejtorëve dhe menaxherëve**

Përveç detyrimit që korrespondon me subjektin raportues, personat që mbajnë poste administrative ose menaxhuese në subjektin raportues mbahen përgjegjës, duke qenë administrator të vetëm apo organe kolegjiale (borde), janë përgjegjës për çdo shkelje e cila i

atribuohet këtyre të fundit.

## **KAPITULLI VI PROCEDURA E NDËSHKIMEVE ADMINISTRATIVE**

### **Neni 48**

#### **Verifikimi i dyshimit për moszbatim të ligjit**

1. Në rastet kur NjIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial (vetëm nëse kjo kompetencë i është dhënë në pajtim me paragrafin 5. të nenit 34), dyshojnë se një subjekt raportues nën mbikëqyrjen e tyre ka dështuar për të qenë në përputhje me obligimet që parashihen në këtë ligj, atëherë menjëherë nis procesi i verifikimit të dyshimit dhe ekzistimit të kushteve për shqiptimin e ndëshkimit administrativ.

2. Nëse është e nevojshme, mund të kryet inspektim i pajtueshmërisë, siç përcaktohet me këtë ligj, me qëllim që të verifikohet dyshimi për moszbatim të këtij ligji dhe ekzistimi i kushteve për shqiptimin e ndëshkimit administrativ.

3. Pas verifikimit të dyshimit, gjetjeve dhe konstatimeve të evidentuara, NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial ofrojnë subjektit raportues mundësinë që të dorëzojë me shkrim observimet e tij rreth të gjeturave brenda dy (2) javësh, pas dhënies së njoftimit me shkrim për dështimin për të qenë në përputhje me dispozitat e ligjit.

4. Njoftimi për dështimin për të qenë në përputhje me obligimet që parashihen në këtë ligj nënshkruhet nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës për mbikëqyrje të pajtueshmërisë në kuadër të NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësve tjerë sektorial, protokollohet dhe dërgohet në mënyrë të verifikueshme tek subjektit raportues.

5. Në bazë të të gjeturave dhe shqyrtimit të observimeve të pranuar NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial për shkeljet në kuadër të kompetencave të dhëna me këtë ligj, duhet të përcaktojnë nëse subjekti raportues ka dështuar që të zbatojë obligimet e përcaktuara në këtë ligj.

6. Në rast se subjekti raportues nuk dorëzon observimet e tij brenda afatit prej dy (2) javësh, kjo nuk pengon në marrjen e vendimit përfundimtar për ndëshkim administrativ.

### **Neni 49**

#### **Procedura e ndëshkimeve administrative**

1. NjIF-K, BQK si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, pasi të kenë konstatuar se ekziston shkelje e dispozitave të këtij ligji, marrin vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ për shkeljet për të cilat i është dhënë kompetencë sipas këtij ligji.

2. Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ sipas këtij ligji merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

3. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, për shkeljet në kuadër të kompetencave të dhëna me këtë ligj, njoftojnë subjektin raportues për dështimin për të qenë në përputhje



me obligimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, duke dërguar vendimin për shqiptimin e ndëshkimit administrativ. Njoftimi për shqiptimin e ndëshkimit administrativ bëhet, përmes dorëzimit të vendimit në mënyrë të verifikueshme te subjekti raportues në përputhje me kërkesat e Ligjit për Procedurën Administrative.

4. Menjëherë pas pranimit të vendimit për shqiptimin e ndëshkimit administrativ subjekti raportues ndërmerr veprime për të siguruar përputhshmërinë me këtë ligj. Subjekti raportues i ndërmerr këto masa brenda afatit kohor të caktuar në vendim.

5. Pajtueshmëria e subjektit raportues me dispozitat e këtij ligji verifikohet dhe për këtë qëllim NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të bëjnë inspektime në vend gjatë periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për ndëshkimin administrativ apo duke u bazuar në kërkesën e subjektit raportues.

6. Nëse subjekti raportues të cilit i është shqiptuar ndëshkimi administrativ sipas këtij neni nuk ka ndërmarrë veprime pajtueshmërie brenda periudhës kohore të definuar në vendimin për ndëshkim administrativ, atëherë NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial, mund të shqiptojnë gjobë monetare në baza ditore për çdo ditë që shkelja vazhdon derisa të përcaktohet se pajtueshmëria e kërkuar është arritur. Procedura e njëjtë e ndëshkimit administrativ dhe njoftimeve të definuar sipas këtij neni aplikohen në këtë rast.

7. Për çdo ditë të mos-pajtueshmërisë, prej periudhës kohore të përcaktuar në vendimin e NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësve tjerë sektorial, subjekti raportues i nënshtrohet gjobës ditore prej pesëqind (500) euro.

8. Për ndëshkimin administrativ sipas paragrafit 6. të këtij neni, ku shqiptohet gjoba monetare në baza ditore, NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial marrin vendim që përcakton numrin e ditëve gjatë së cilave subjekti raportues nuk ka qenë në pajtueshmëri me këtë ligj brenda periudhës kohore të definuar në vendim, siç përcaktohet në paragrafin 4. të këtij neni. Vendimi me shkrim për gjobë monetare në baza ditore përcakton ekzistencën e dështimit për të ndërmarrë veprime pajtueshmërie sipas vendimit për ndëshkim dhe dispozitave të këtij ligji, si dhe shqiptimin e gjobës sipas numrit të ditëve të mos-pajtueshmërisë.

9. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nuk do të marrin vendime për ndëshkime administrative për të njëjtat mos-pajtueshmëri të subjekteve raportuese pasi që shkelja e përsëritur konsiderohet siç është definuar në nenin 41 dhe në nenin 43 të këtij ligji.

10. Për subjektet raportuese të cilët veprojnë duke u bazuar në licencë apo autorizim tjetër, NjIF-K informon autoritetin kompetent licencues apo autorizues, për dështimin për të iu përmbajtur ligjit siç definohet në nenin 42 të këtij ligji. NjIF-K mundet gjithashtu t'i rekomandoj autoritetit licencues apo autorizues që të nisë procesin për përcaktimin se a duhet të pezullohet apo tërhiqet licenca e punës apo autorizimi.

#### **Neni 50**

#### **Ankesa administrative tek NjIF-K**

1. Subjekti raportues mund të ankohet kundër vendimit mbi ndëshkimin administrativ të vendosur nga NjIF-K duke dërguar ankesën me shkrim te Drejtori i NjIF-K brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit mbi ndëshkimin administrativ, për shkak të mos-pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji. Subjekti raportues mund të kërkojë revokimin, anulimin apo modifikimin e vendimit të NjIF-K.

2. Drejtori i NjIF-K themelon një komision të përbërë nga tre (3) zyrtarë të NjIF-K i cili komision rishikon vendimin përkitazi me ndëshkimin administrativ, duke i marrë parasysh të gjitha informatat relevante të ofruara si dhe dispozitat e këtij ligji.

3. Me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit, zyrtarët e NjIF-K të cilët kanë marrë pjesë në përgatitjen dhe marrjen e vendimit, nuk mund të përfshihen në komisionin e themeluar nga Drejtori i NjIF-K në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni.

4. Ankesa pezullon pagesën dhe zbatimin e sanksionit administrativ, derisa komisioni i themeluar sipas paragrafit 2. të këtij neni të merr një vendim në lidhje me ankesën.

5. NjIF-K vendosë mbi ankesën, me shkrim, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të ankesës, përveç rasteve të veçanta për të cilat për shkak të ndërlikueshmërisë së tyre kërkojnë kohë shtesë por jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë.

6. Komisioni i themeluar nga Drejtori i NjIF-K mund të vendosë:

6.1. të refuzojë ankesën si të papranueshme;

6.2. të konfirmojë validitetin e vendimit dhe të refuzojë ankesën;

6.3. të anulojë/revokojë vendimin dhe të aprovojë ankesën;

6.4. të modifikojë vendimin duke e aprovuar pjesërisht ankesën; dhe

6.5. të udhëzojë organin përgjegjës brenda NjIF-K që të lëshojë një vendim kur lëshimi i tij ishte refuzuar kundërligjshëm.

### **Neni 51**

#### **Ankesa administrative tek BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial**

1. Subjekti raportues mund të ankohet kundër vendimit mbi ndëshkimin administrativ të vendosur sipas këtij ligji nga BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë në pajtim me këtë ligj, duke dërguar ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit mbi ndëshkimin administrativ nga BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial, për shkak të mos-pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji.

2. BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nxjerrin akte nënligjore për sektorët nën fushëveprimin e tyre mbikëqyrës në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji, lidhur me procedurën e trajtimit të ankesës sipas këtij ligji.

### **Neni 52**

#### **Ankesa në gjykatë**

1. Shqiptimi i ndëshkimit administrative nga NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të ankimohet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të vendimit final për ndëshkim administrativ.

2. Ankesa e ushtruar në Gjykatë nuk pezullon pagesën e ndëshkimit administrativ të definuar

në nenin 50 të këtij Ligji.

### **Neni 53**

#### **Pagesa dhe ekzekutimi i ndëshkimeve administrative**

1. Subjekti raportues paguan gjobën administrative përmes transferit bankar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dërgimit të vendimit final. Këtij vendimi i bashkëngjitet edhe udhëzimi për pagesën e gjobës.

2. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial, në koordinim me Ministrinë e Financave sigurojnë kompensimin e pagesave të gjobave administrative në rast të aprovimit të ekzekutueshëm të ankesës së subjektit raportues nga Gjykata.

3. Në rast të mos-pagesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dërgimit të vendimit final përkitazi me ndëshkimin administrativ, NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial kërkojnë ekzekutimin në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial kërkojnë nga subjekti raportues që të kompensojë shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet e tjera të bëra gjatë procedurës së ekzekutimit.

### **Neni 54**

#### **Ndikimi i procedurës penale në procedurën e ndëshkimit administrativ**

Nëse paralelisht ndodhin hetimet penale dhe procedura e ndëshkimit administrativ, NjIF-K, BQK apo mbikëqyrësit e tjerë sektorial pezullojnë procedurën e ndëshkimit administrativ deri në përfundimin e procedurës penale.

### **Neni 55**

#### **Publikimi i Vendimeve mbi ndëshkimet administrative**

1. NjIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë me këtë ligj, publikojnë në ueb-faqen zyrtare vendimet finale të ekzekutueshme përkitazi me ndëshkimin administrative, duke deklaruar llojin dhe natyrën e dështimit për pajtueshmëri, identitetin e subjektit raportues dhe ndëshkimin administrativ.

2. NjIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të vendosin që të mos bëjnë publik ndëshkimin administrativ, të vonojë publikimin apo të publikojë ndëshkimin administrativ në mënyrë që subjekti raportues apo personi fizik i ndëshkuar të mos jetë i identifikueshëm, nëse publikimi i definuar në paragrafin 1. të këtij neni:

2.1. është jo-proporcional me seriozitetin e dështimit për pajtueshmëri;

2.2. mund të rrezikojë stabilitetin e tregut financiar; apo

2.3. mund të rrezikojë hetimet penale në vijim e sipër.

3. NjIF-K dhe BQK mbajnë informatat e publikuara në pajtim me paragrafin 1., të këtij neni për të paktën pesë (5) vite.

## KAPITULLI VII VEPRAT PENALE

### Neni 56

#### Vepra penale e pastrimit të parave

1. Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon:

1.1. konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;

1.2. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij;

1.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal;

1.4. merr, posedon, shfrytëzon apo tenton të merr, posedojë apo shfrytëzojë pasurinë;

1.5. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;

1.6. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.5. të këtij paragrafi.

2. Për qëllime të paragrafit 1. të këtij neni, përfaqësimet mund të jenë bazë për të besuar së pasuria e caktuar përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale, madje edhe nëse ato përfaqësimet vetëm tërthorazi mbështesin besimin se ajo përbën pasuri të fituar me anë të veprës penale.

3. Pa cenuar legjislacionin penal në fuqi lidhur me personin i cili ka kryer veprat e ndërlidhura penale jashtë fushëveprimit të këtij paragrafi:

3.1. personi mund të dënohet për vepër penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë asnjëherë i dënuar për vepër të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerr pasuria e fituar me anë të veprës penale;

3.2. i njëjti person mund të ndiqet dhe të dënohet në procedura të veçanta për vepra penale të pastrimit të parave dhe të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është

nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale; dhe

3.3. gjykatat e Kosovës mund të kenë juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave, madje edhe nëse ato nuk kanë juridiksion territorial mbi veprat e ndërlidhura penale prej të cilave është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të pastrimit të parave, ngaqë ka qenë kryer jashtë Kosovës.

#### **Neni 57**

##### **Vepra Penale e Financimit të Terrorizmit**

1. Kushdo që me qëllim kryen, merr pjesë si bashkëpunëtor, siguron ose mbledhë fonde apo organizon ose drejton të tjerët drejtpërdrejt të ofrojnë ose të mbledhin fonde, apo përpjekja për ta bërë këtë, përmes çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim që ato të përdoren ose në njohuri se ato do të përdoren në mënyrë të plotë ose pjesërisht për të kryer një akt terrorist, nga një terrorist; ose nga një organizatë terroriste, konsiderohet të ketë kryer aktin e financimit të terrorizmit.

2. Vepra penale është kryer, pavarësisht se a ka ndodh një akt terrorist i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, ose nëse fondet janë përdorur në fakt për të kryer akt të tillë.

3. Financimi i terrorizmit është i dënueshëm me burgim nga pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite, dhe me gjobë deri pesëqind mijë (500.000) euro.

4. Tentativa për të kryer veprën penale të financimit të terrorizmit apo ndihmesa, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi në kryerjen e ndonjë vepre të tillë, dënohet sikur vepra të kishte përfunduar.

#### **Neni 58**

##### **Kërcënimi përkitazi me Raportimin e Aktivitetit apo Transaksionit të Dyshimtë**

Kushdo që përdor forcën apo kërcënimin serioz apo ndonjë masë tjetër shtrëngimi, apo që premtan ndonjë dhuratë apo formë tjetër përfitimi për të nxitur personin tjetër që të heqë dorë nga raportimi siç kërkohet me nenin 26. të këtij ligji apo për të dhënë deklaratë të rreme me qëllim të dështimit për të deklaruar informacionin e vërtetë të NJIF-K, institucionet e hetuesisë, prokurorit apo gjyqtarit, kur informata e tillë ka të bëjë me obligimet raportuese sipas nenit 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzetë e pesë mijë (125.000) euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

#### **Neni 59**

##### **Veprat e tjera penale**

1. Cilido person që, duke siguruar ndonjë informacion, ose duke raportuar, duke bërë certifikata ose deklarime sipas këtij ligji, me dashje bën, çfarëdo deklarate të rëndësishme të rrejshme ose me qëllim nuk i zbulon informacionet e rëndësishme; apo bën apo shfrytëzon çfarëdo dokumenti duke e ditur se dokumenti përmban deklaratën ose shënime të rëndësishme të rrejshme, kryen vepër penale të dënueshme deri në pesë (5) vite burgim dhe me gjobë deri në njëqind mijë (100,000) euro.

2. Kushdo që me dashje shkatërron ose largon çfarëdo të dhënash të cilat duhet të mbahen në pajtim me paragrafët 3. deri 7. të nenit 19, paragrafët 1., 2. dhe 3 të nenit 20, paragrafin 7. të nenit 24, paragrafin 3. të nenit 25, paragrafët 1. dhe 3. të nenit 26 paragrafin 3. të nenit 29,

paragrafin 8. të nenit 31 dhe paragrafin 3. të nenit 32 të këtij ligji; apo dështon për të bërë një raport në përputhje me paragrafët 1. dhe 2. të nenit 26, paragrafit 4. të nenit 29, paragrafët 2. dhe 6. të nenit 31, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro. Nëse çfarëdo vepre penale e paraparë me këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues ose funksionit të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.

3. Subjekti raportues apo nëpunësi, drejtori, agjenti ose punonjësi i tyre i cili me dashje shkel paragrafin 4. të nenit 26 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe/ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro. Nëse ndonjëra prej veprave penale të specifikuara në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të ndonjë roli rregullues ose funksionit të zbatimit të ligjit, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet dhe/ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

4. Kushdo që me dashje pranon ose paguan valutën në kundërshtim me nenet 29 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vjet dhe me gjobë deri në pesëmijë (5.000) euro ose me dyfishin e shumës së valutës së pranuar apo të paguar, cilado prej tyre që është më e lartë.

5. Një zyrtar i NJIF-K-së, i cili me dashje raporton informacionin ose zbulon informacionin në pajtim me paragrafin 1. të nenit 15 të këtij ligji apo ia zbulon informacionin prokurorit publik apo një gjykatë, duke e ditur se informacioni i tillë përmban falsitete, pasaktësi, ose gabime të rëndësishme; shkatërron ose largon çfarëdo të dhëna të cilat duhet të mblidhen nga NJIF-K-ja në pajtim me këtë ligj, ndryshe nga çfarë është paraparë me politikën e mbajtjes dhe të shkatërrimit të dokumenteve të krijuar nga NJIF-K-ja; apo zbulon çfarëdo informacioni të përshkruar në paragrafin 1. të nenit 15 ndryshe nga çfarë është paraparë me paragrafin 2. të nenit 15, përveç nëse është i autorizuar me shkrim nga Drejtori i NJIF-K-së, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në dy (2) vite dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro. Nëse vepra penale e përcaktuar në këtë paragraf kryhet me qëllim të pengimit të rolit rregullues apo funksionit të zbatimit të ligjit, kryerësi do të dënohet me burgim deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

6. Informacioni ose dështimi i sigurimit të informacionit mund të jetë i rëndësishëm edhe nëse pranuesi nuk është ndikuar apo çorientuar nga ato.

7. Kushdo që kundërligjshëm refuzon apo pengon inspektimin e ligjshëm të ndërmarrë në pajtim me nenet 34, 35 dhe 36 të këtij ligji ose me dashje fsheh shënimet që duhet të mbahen dhe të paraqiten në pajtim me këtë ligj, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në një (1) vit dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

8. Kushdo që me dashje shkel urdhrin me të cilën urdhërohet masa e përkohshme për ngrirjen e pasurisë sipas nenit 27 të këtij ligji, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në pesë (5) vjet dhe me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

9. Kushdo që me dashje nuk deklaron në përputhje me paragrafët 1. dhe 2. të nenit 33 të këtij ligji kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në (5) vite ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

## Neni 60

### Përgjegjësia penale e personave juridikë

1. Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili ka kryer vepër

penale duke vepruar në emër të personit juridik brenda autorizimeve të tij, përveç nëse ai person dëshmon se:

1.1. vepra penale është kryer pa pëlqimin apo dijeninë e tij; dhe

1.2. personi ka ndërmarr hapa të arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e veprës që do të ishte ushtruar nga ai person duke pasur parasysh natyrën e funksioneve të tij në atë kapacitet.

#### **Neni 61**

#### **Lirimi nga përgjegjësia**

Asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional nuk mund të ndërmerret ndaj ndonjë personi apo entiteti ose subjekti raportues, sipas këtij ligji, ose ndaj drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve të tyre të përkohshëm apo të përhershëm bazuar vetëm në transmetimin e informatave në mirëbesim, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në pajtim me këtë ligj, apo transmetimin vullnetar të informatave në mirëbesim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë, dyshimin për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit tek NJIF-K.

### **KAPITULLI VIII**

### **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

#### **Neni 62**

#### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të pastrimit të parave dhe aktivitetit terrorist.

2. Procedurat për sigurimin e bashkëpunimit sipas paragrafit 1. të këtij neni janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozitat e tjera të tilla përkatëse të ligjeve në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me të.

3. Një kërkesë sipas këtij neni dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike në pajtim me ligjet dhe marrëveshjet në fuqi, i cili do të përcillet tek Zyra për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ose autoriteti tjetër kompetent.



## **KAPITULLI IX**

### **SEKRETI PROFESIONAL, MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLASIFIKIMI I INFORMATAVE**

#### **Neni 63**

##### **Sekreti profesional**

1. Pavarësisht nga paragrafi 7. i nenit 31 dhe paragrafi 5.2. i nenit 35 të këtij ligji, sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që:

1.1. duhet zbuluar në pajtim me këtë ligj; ose

1.2. janë mbledhur dhe ruajtur në pajtim me këtë ligj dhe kërkohen qoftë nga NjIF-K, qoftë nga policia lidhur me një hetim për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit apo gjyqtarit hetues.

#### **Neni 64**

##### **Mbrojtja e të dhënave**

1. NjIF-K është kontrollues i të dhënave siç definohet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Informatat e pranuar dhe mbajtura nga NjIF-K sipas këtij ligji përpunohen dhe administrohen në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Grumbullimi, përpunimi dhe përdorimi dhe ruajtja e të dhënave personale nga subjektet raportuese kufizohet në atë që është e domosdoshme për qëllimin e veprimit në përputhshmëri me kërkesat e këtij ligji dhe të dhënat personale nuk duhet të përpunohen më tutje në mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim. Në veçanti, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime komerciale ndalohet.

#### **Neni 65**

##### **Klasifikimi i informatave**

NjIF-K është autoritet i klasifikimit sipas ligjit në fuqi për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë.

## **KAPITULLI X**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 66**

##### **Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit**

1. Ministri i Financave miraton akte nënligjore për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe për zbatimin e dispozitave tjera të këtij ligji.

2. NjIF-K, BQK dhe autoritetet mbikëqyrëse sektoriale siç mund të jetë rasti, në çdo kohë në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me njëra tjetrën miratojnë, ndryshojnë apo shfuqizojnë akte nënligjore me qëllim të ofrimit të politikave, udhëzimeve ose udhëzuesve për subjektet raportuese për zbatimin e detyrimeve të këtij ligji dhe për promovimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me këtë ligj.

**Neni 67**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr.03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Ligji nr.04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.

**KAPITULLI XI**  
**DISPOZITAT KALIMTARE**

**Neni 68**  
**Dispozitat kalimtare për zbatimin e Ligjit**

1. Subjektet raportuese zbatojnë dispozitat e reja të këtij ligji për klientët ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut si pjesë e monitorimit të vazhdueshëm të llogarive dhe marrëdhënieve të biznesit.

2. Çdo marrëveshje e nënshkruar ose çfarëdo udhëzimi, urdhërese apo udhëzues administrativ që janë nxjerrë në bazë të dispozitave të Ligjit 03/L-196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-178 që tashmë janë shfuqizuar, mbeten në fuqi derisa të ndryshohen, plotësohen ose revokohen.

**Neni 69**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -096**  
**25 maj 2016**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-015-2016, datë 13.06.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.**